

20150200405

## LIGJ PËR AKADEMINË PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIKË

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSME

#### Lënda e ligjit

##### Neni 1

Me këtë ligj themelohet dhe rregullohet puna e Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë (në tekstin e mëtejme: Akademia) si institucion publik për praninë dhe përsosje profesionale të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë, trajnimit të vazhdueshëm dhe përparimi të profesionalizmit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurori publike, trajnimit të subjekteve të cilët marrin pjesë në zbatimin e ligjeve nga sfera e jurisprudencës, kryerja e veprimtarisë analitike nga sfera e teorisë dhe praktikës së jurisprudencës, organet e menaxhimit dhe financimi të Akademisë.

#### Qëllimi i themelimit të Akademisë

##### Neni 2

Qëllimi i themelimit të Akademisë është që të sigurojë kryerje profesionale, të pavarur, të paanshme dhe efikase të funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, si dhe kryerje profesionale dhe efikase të punëve të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurorinë publike.

#### Veprimtaria e Akademisë

##### Neni 3

(1) Akademia bën pranimin dhe përsosjen profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, përsosjen e vazhdueshme profesionale dhe përparimin e dijeve të gjykatësve dhe prokurorëve publikë tanimë të zgjedhur gjatë kryerjes së funksionit të tyre, si dhe përsosjen dhe trajnimin për kryerje profesionale, etike dhe profesionale të detyrave të punës të subjekteve nga neni 1 i këtij ligji, në pajtim me ligjin dhe standardet dhe parimet ndërkombëtare.

(2) Akademia veprimtarinë e vet e zbaton përmes:

- pranimin të dëgjuesve në trajnimin fillestar nëpërmjet organizimit dhe dhënies së provimit pranues,
- organizimit dhe zbatimit të trajnimit fillestar të kandidatëve të ardhshëm për gjykatës dhe prokurorë publikë në gjykatat themelore dhe në prokuroritë themelore publike dhe zbatimin e provimit përfundimtar,
- organizimit dhe zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm për përparimin e profesionalizmit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë,
- organizimit dhe zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe në prokurorinë publike si dhe trajnimit të subjekteve të theksuara në nenin 1 të këtij ligji,
- zbatimit të veprimtarisë analitike nga sfera e teorisë dhe praktikës së jurisprudencës dhe
- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe Statutin e Akademisë (në tekstin në vijim: Statuti).

(3) Për zbatim të veprimtarisë, Akademia:

- organizon dhe zbaton konferenca vendase dhe ndërkombëtare, tryeza të rrumbullakëta, seminare, programe studimore për vizita profesionale dhe forma tjera të trajnimit dhe përsosjes profesionale,

- vendos dhe mban bashkëpunim në fushën e trajnimit me institucione të ngjashme vendase dhe institucione të huaja, organizata, shoqata dhe fondacione, në veçanti me shoqatat profesionale të gjykatësve dhe prokurorëve publikë dhe odave, dhe për shkak të zhvillimit të konceptit të dimensionit interdisiplinar dhe social të trajnimeve,

- bashkëpunon me rrjetet evropiane të institucioneve për trajnim, Rrjetin e Lisbonës të Këshillit të Evropës dhe Rrjetit Evropian për Trajnim të Bashkimit Evropian, realizon këmbim ndërkombëtar të gjykatësve, prokurorëve publikë, si dhe të subjekteve të theksuara në nenin 1 të këtij ligji,

- organizon dhe mban bibliotekë,

- boton publikime dhe kryen veprimtari tjetër botuese për nevojat e veta,

- realizon bashkëpunim me fakultetet juridike për shkak të zhvillimit të programeve për orientim profesional dhe përgatitjen e studentëve nga fakultetet juridike për pranim në Akademi dhe

- organizon dhe merr pjesë në projektet hulumtuese dhe veprimtari tjera me rëndësi për përparimin dhe përsosjen e trajnimeve në jurisprudencë.

#### Neni 4

(1) Akademia ka cilësi të personit juridik.

(2) Selia e Akademisë është në Shkup.

### **Aktet e Akademisë**

#### Neni 5

(1) Akt themelor i Akademisë është Statuti.

(2) Me Statut rregullohen:

- emërtimi, organizimi i brendshëm dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë së Akademisë,

- menaxhimi dhe udhëheqja me Akademinë,

- të drejtat dhe obligimet e subjekteve nga neni 1 i këtij ligji,

- përbërja, mënyra e formimit, si dhe mënyra e vendimmarrjes dhe fushëveprimi i punës së organeve dhe trupave të Akademisë,

- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Akademisë në qarkullimin juridik,

- pranimi i dëgjuesve në trajnimin fillestar,

- përmbajtja e programeve për provim pranues, trajnimit fillestar, programeve për trajnim të vazhdueshëm, programeve për praktikim të funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik dhe programeve tjera të specializuara,

- kriteret për zgjedhje të ligjëruesve dhe mentorëve,

- mënyra e financimit dhe përdorimi i mjeteve për punë në Akademi dhe

- çështje tjera.

(3) Statutin e miraton Këshilli Drejtues i Akademisë me shumicën e dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(4) Statuti dhe aktet tjera të përgjithshme të Akademisë shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e Akademisë dhe në tjetër mënyrë me të cilën mundësohet qasje e tyre te opinioni.

### **Vula e Akademisë**

#### Neni 6

(1) Akademia ka vulë.

(2) Vula e përmban emrin Republika e Maqedonisë, stemën e Republikës së Maqedonisë, emërtimin dhe selinë e Akademisë.

(3) Forma dhe përmbajtja e vulës, pamja e shenjave dhe shënimeve tjera dhe mënyra e shfrytëzimit rregullohet me Statutin e Akademisë.

#### Neni 7

Në Akademi nuk lejohet organizim dhe veprim politik dhe partiak.

### **Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në organet e Akademisë**

#### Neni 8

Gjatë konstituimit të organeve dhe trupave të Akademisë, emërimin e ligjëruesve dhe mentorëve, konstituimit të Komisionit për provim pranues, Komisionit për provim përfundimtar dhe Komisionit për verifikim sigurohet përfaqësim adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë, pa u prishur kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

### **Përfaqësimi i drejtë**

#### Neni 9

Gjatë selektimit të kandidatëve për pranim në trajnimin fillestar në Akademi, pa u prishur kriteret e parapara me këtë ligj, sigurohet përfaqësim i drejtë dhe adekuat i qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë.

## **II. ORGANET E AKADEMISË**

#### Neni 10

Organet e Akademisë janë: Këshilli Drejtues, drejtori, zëvendësdrejtori dhe Këshilli Programor.

### **Këshilli drejtues**

#### Neni 11

(1) Këshilli drejtues është organ i menaxhimit të Akademisë dhe e përbëjnë 9 anëtarë.

(2) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin Drejtues i propozon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë edhe atë nga një anëtar nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, nga gjykatat e apelit, nga gjykatat themelore, si dhe një anëtar nga Gjykata Administrative ose nga Gjykata e Lartë Administrative.

(3) Katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre në Këshillin Drejtues i propozon Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë edhe atë nga një anëtarë nga radhët e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, nga prokuroritë e larta publike, nga prokuroritë themelore publike dhe nga Prokuroria Themelore Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

(4) Ministri i Drejtësisë emëron një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë.

(5) Në punën e Këshillit Drejtues merr pjesë drejtori i Akademisë (në tekstin e mëtejme: drejtor), pa të drejtë vote.

#### Neni 12

(1) Për anëtar ose zëvendës të Këshillit Drejtues nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë mund të zgjidhen gjykatës dhe prokurorë publikë të cilët e kanë dhënë provimin profesional të cilin e zbaton Akademia.

(2) Dispozitat për mënyrën e zbatimit të provimit për drejtor zbatohen në mënyrë adekuate edhe gjatë zbatimit të provimit për anëtarët e Këshillit drejtues.

(3) Anëtarët e Këshillit Drejtues detyrimisht duhet aktivisht të njohin një nga gjuhët e Bashkimit Evropian, prej të cilave detyrimisht gjuhën angleze që dëshmohet me posedimin e certifikatës së pranuar ndërkombëtare të lëshuar nga testator zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropianë të nivelit B1 të CEFR, përkatësisht IELTS me 3,5 - 4,5 pikë PET, BEKP, BULATS, ose Aptis, ose TOEFEL PBT të paktën 450 pikë, TOEFEL CBT të paktën 135 pikë, ose TOEFEL IBT të paktën 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose Gete certifikatë. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të posedojnë integritet për kryerjen e funksionit, për çfarë zbatohen teste për integritet dhe teste psikologjike.

(4) Formën dhe përmbajtjen e testit psikologjik dhe testit për integritet, i rregullojnë Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.

(5) Testi psikologjik të cilin e zbaton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë ka për qëllim që nëpërmjet kontrollit të aftësive sociale t'i afirmojë kandidatët për kryerjen e funksionit anëtar të Këshillit Drejtues.

(6) Testi për integritet të cilin e zbaton Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë bazohet në kodekset ekzistuese etike dhe profesionale dhe ka për qëllim kontrollin e vlerave etike dhe morale të kandidatit për kryerjen e funksionit anëtar i Këshillit drejtues dhe përbëhet nga testi i cili zbatohet në formë me shkrim dhe në mënyrë anonime, në bazë të listës së përcaktuar standarde të pyetjeve.

(7) Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë detyrohen që gjatë zbatimit të tekstit psikologjik dhe testit për integritet, të mbajnë llogari për mbrojtjen të dhënave personale, prestigjin dhe dinjitetin e kandidatit, në pajtim me ligjin.

(8) Për zbatimin e testit psikologjik dhe të testit për integritet Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë angazhojnë persona profesionalë nga institucion profesional i pavarur dhe me akreditim të plotë.

(9) Testi psikologjik zbatohet në bazë të testeve psikologjike të pranura ndërkombëtare të cilët zbatohen në së paku një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD-së.

### Neni 13

Këshilli Drejtues i kryen punët në vijim:

- miraton Statut dhe akte tjera të përgjithshme të Akademisë dhe e përcjell zbatimin e tyre,
- zgjedh kryetar të Këshillit Drejtues dhe zëvendës të tij,
- e emëron, përcakton ndërprerje të mandatit dhe e shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin,
- vendos për largimin e përkohshëm nga puna të drejtorit gjatë procedurës së ngritur për shkarkim,
- konstaton dhe përcakton ndërprerje dhe shkarkim të anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit Drejtues,
- emëron dhe përcakton ndërprerje dhe shkarkim të anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit Programor,
- e zgjedh dhe konstituon Komisionin për provim pranues dhe Komisionin për provim përfundimtar, e zgjedh kryetarin e Komisionit për provim pranues dhe kryetarin e Komisionit për provim përfundimtar, përcakton ndërprerje të funksionit të anëtarëve të Komisionit për provim pranues dhe Komisionit për provim përfundimtar dhe zëvendësit e tyre dhe i miraton raportet e tyre për rrjedhën e procedurës për dhënien e provimeve,
- e përcakton listën e ligjëruesve me propozim të drejtorit,

-e përcakton listën e ligjëruesve të cilët i përgatisin pyetjet për trajnim fillestar si edhe listën e ligjëruesve të cilët do t'i përpilojnë pyetjet e provimeve të përcaktuara me ligj të veçantë,

-i shkarkon ligjëruesit e Akademisë nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë me propozim të drejtorit,

-e përcakton listën e mentorëve me propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë dhe e përcakton ndërprerjen e cilësisë së mentorit me propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë,

-me propozim të Këshillit programor, përcakton programe për provim pranues, për trajnim fillestar dhe për provim përfundimtar, programe për trajnim të vazhdueshëm, program për praktikimin e funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, programe të përgjithshme dhe të specializuara për trajnim,

-miraton plan vjetor financiar që e dorëzon te organet kompetente,

-e përcakton mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve për punën e Akademisë,

-miraton plan strategjik të Akademisë,

-e miraton llogarinë përfundimtare dhe Programin për punën e Akademisë të parashtruar nga drejtori,

-më së voni deri më 1 mars të vitit rrjedhës, miraton raport vjetor për punën e Akademisë në vitin paraprak dhe e dorëzon te institucionet e përfaqësuara në Këshillin drejtues,

-jep udhëzime për bashkëpunim me institucionet e përafërta, organizatat dhe shoqatat nga vendi dhe nga jashtë, për projekte ndërkombëtare, grante dhe donacione,

-miraton Rregullore për punën e vet,

-miraton akte për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës dhe akte tjera të përgjithshme, me propozim të drejtorit,

-miraton vendime, aktvendime dhe konkluzione dhe

-kryen punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me Statutin.

### **Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues**

#### **Neni 14**

Mandati i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre në Këshillin Drejtues, përveç anëtarëve sipas funksionit, zgjat dy vite me të drejtë për rizgjedhje.

### **Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i anëtarit të Këshillit Drejtues**

#### **Neni 15**

(1) Anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit Drejtues i ndërpritet mandati:

-me kërkesë të tij,

-për shkak të vdekjes,

-nëse i ndërpritet funksioni ose marrëdhënia e punës në organin ku e kryen funksionin ose ka themeluar marrëdhënie pune dhe

-nëse pengohet ta kryejë funksionin anëtar ose zëvendësanëtar i Këshillit Drejtues më shumë se gjashtë muaj për shkak të sëmundjes ose shkaqeve tjera të arsyeshme.

(2) Anëtari dhe zëvendësanëtari i Këshillit Drejtues shkarkohet për shkak të:

-kryerjes së funksionit në mënyrë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme,

-nëse me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar masë për ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

-nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) ose (2) të këtij neni, organi i cili e ka emëruar anëtarin, përkatësisht zëvendës-anëtarin i cili është shkarkuar ose mandati i të cilit ka pushuar, nominon anëtar të ri, përkatësisht zëvendësanëtar më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit për shkarkimin, përkatësisht ndërprerjen e mandatit.

(4) Mandati i anëtarit të sapoemëruar, përkatësisht zëvendësanëtarit të Këshillit Drejtues zgjat deri në skadimin e mandatit për të cilin janë emëruar anëtarët e Këshillit Drejtues.

(5) Deri në emërimin e anëtarit të ri të Këshillit Drejtues, funksionin anëtar e kryen zëvendësanëtari, ndërsa deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Këshillit Drejtues funksionin kryetar e kryen zëvendëskryetari i Këshillit Drejtues.

### **Kryetari i Këshillit Drejtues**

#### Neni 16

(1) Kryetari i Këshillit Drejtues dhe zëvendësi i tij zgjidhen nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, anëtarë të Këshillit Drejtues.

(2) Mandati i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues zgjat një vit, me mundësi për rizgjedhje.

### **Mënyra e punës së Këshillit Drejtues**

#### Neni 17

(1) Punët nga fushëveprimi i vet Këshillit Drejtues i kryen në mbledhje publike.

(2) Mbledhjet e Këshillit Drejtues i konvokon dhe me ato udhëheq kryetari i Këshillit Drejtues.

(3) Mbledhja e Këshillit Drejtues mund të konvokohet edhe me kërkesë të drejtorit ose anëtarit të Këshillit Drejtues.

(4) Këshilli Drejtues mban mbledhje nëse janë prezent më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

(5) Konsiderohet se anëtari i Këshillit Drejtues është prezent nëse ekziston lidhje telefonike në dy drejtime ose lidhje tjetër (videokonferenë), e cila garanton identifikimin dhe lejon pjesëmarrje në diskutim dhe miratimin e vendimit. Vota e këtij anëtari vërtetohet me procesverbal nga ana e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Drejtues.

(6) Për çdo mbledhje mbahet procesverbal të cilin e nënshkruajnë kryetari i mbledhjes dhe mbajtësi i procesverbalit. Mbledhja mund të incizohet edhe në mënyrë audiovizuale.

### **Mënyra e vendosjes e Këshillit Drejtues**

#### Neni 18

(1) Këshilli Drejtues miraton vendime me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues.

(2) Nëse nuk sigurohet shumicë e nevojshme nga paragrafi (1) i këtij neni, mbledhja prolongohet dhe kryetari menjëherë cakton mbledhje të re e cila do të mbahet më së voni në afat prej tetë ditësh.

### **Kompensimi i shpenzimeve të anëtarëve të Këshillit Drejtues**

#### Neni 19

Kryetari i anëtarëve të Këshillit Drejtues kanë të drejtë për kompensim të shpenzimeve rrugore dhe ditore, në pajtim me rregullat me të cilat rregullohen ato çështje, përveç anëtarëve sipas funksionit.

## Drejtori dhe zëvendësdrrejtori

### Neni 20

- (1) Drejtori është organ udhëheqës dhe ekzekutiv i Akademisë. Drejtori ka zëvendës.
- (2) Drejtorin dhe zëvendësdrrejtorin i emëron Këshilli Drejtues në bazë të shpalljes publike e cila publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe të paktën në dy gazeta ditore prej të cilave njëra nga gazetatat të cilat botohen në gjuhën maqedonase dhe njëra nga gazetatat në gjuhën të cilën e flasin të paktën 20% të qytetarëve të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase.
- (3) Këshilli Drejtues është i obliguar vendimin për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendësdrrejtorit ta miratojë të paktën 9 muaj para skadimit të mandatit të drejtorit, përkatësisht zëvendësdrrejtorit.
- (4) Afati i paraqitjes në shpalljen publike është 15 ditë nga dita e shpalljes së saj në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".
- (5) Për drejtor, përkatësisht zëvendësdrrejtor emërohet personi i cili ka të paktën tetë vjet përvojë pune si gjykatës ose prokuror publik, me veçori të larta profesionale dhe kompetencë dhe rezultate në punë, i cili ka dhënë provimin për drejtor në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe i cili në mënyrë aktive njih një nga gjuhët e Bashkimit Evropian, prej të cilave detyrimisht gjuhën angleze që dëshmohet me posedimin e certifikatës së pranuar ndërkombëtare të lëshuar nga testator zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testuesve evropianë të nivelit B2 të CEFR, përkatësisht IELTS me 5 - 6 pikë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS, ose Aptis, ose TOEFEL PBT të paktën 500 pikë, TOEFEL CBT të paktën 175 pikë, ose TOEFEL IBT të paktën 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose Gete certifikatë, Test Daf.
- Drejtori, përkatësisht zëvendësdrrejtori duhet të posedojnë integritet për kryerjen e funksionit, për çka zbatohen teste për integritet dhe teste psikologjike, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
- (6) Testin psikologjik të cilin e zbaton Këshilli Drejtues i Akademisë ka për qëllim me anë të kontrollit të aftësive speciale t'i afirmojë kandidatët për kryerjen e funksionit drejtor përkatësisht zëvendësdrrejtor.
- (7) Testin për integritet të cilin e zbaton Këshilli Drejtues i Akademisë bazohet në kodekset ekzistuese etike dhe profesionale për kryerjen e funksionit drejtor përkatësisht zëvendësdrrejtor dhe ka për qëllim kontrollin e vlerave etike dhe morale të kandidatit për kryerjen e funksionit drejtor përkatësisht zëvendësdrrejtor dhe përbëhet nga testi i cili zbatohet në formë me shkrim dhe në mënyrë anonime, në bazë të listës së përcaktuar standarde të pyetjeve.
- (8) Këshilli Drejtues i Akademisë është i obliguar gjatë zbatimit të testit psikologjik dhe testit për integritet, të mbaj llogari për mbrojtjen e të dhënave personale, prestigjin dhe dinjitetin e kandidatit, në pajtim me ligjin.
- (9) Për zbatimin e testit psikologjik dhe pjesën e parë të testit për integritet Këshilli Drejtues i Akademisë angazhon persona profesionalë nga institucioni profesional i akredituar plotësisht dhe i pavarur.
- (10) Testi psikologjik zbatohet në bazë të testeve psikologjike të pranuar ndërkombëtare të cilët zbatohen të paktën në njërin nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD-së.
- (11) Mënyra për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësdrrejtorit rregullohet me Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.
- Zëvendësdrrejtorin e zëvendëson drejtori në raste kur ai mungon, ose kur për shkak të sëmundjes ose për shkaqe tjera nuk ka mundësi ta kryej funksionin e vet. Zëvendësdrrejtori kryen punë me kompetencë të drejtorit që ai do t'ia besojë.

## **Dhënia e provimit për drejtor**

### **Neni 21**

(1) Provimi për drejtor i nenit 20 të këtij ligji (në tekstin e mëtejme: provimi për drejtor) përbëhet nga dy pjesë, si vijon:

- pjesa e parë (pjesa teorike), me të cilën kontrollohen njohuritë teorike të kandidatëve dhe
- pjesa e dytë (praktike), me të cilën kontrolet aftësia praktike e kandidatëve.

(2) Pjesa e parë e provimit jepet me shkrim në formë elektronike, me përgjigjen e një numri të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter me zgjedhjen me zgjedhjen e një përgjigje të saktë nga zgjidhjet e ofruara të mundshme.

(3) Pyetjes e pjesës së parë të provimit janë nga sfera e jurisprudencës, menaxhmentit të jurisprudencës, menaxhimit me procese, menaxhimit me resurse njerëzore, menaxhimi me kohë me komunikim afarist.

(4) Pjesa e dytë e provimit përbëhet nga:

- shembulli praktik i cili përmban rast konkret dhe
- përgjigje të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter të cilat kandidati duhet t'i përgjigjet në bazë të analizës së shembullit praktik.

(5) Mënyra e dhënies së provimit për drejtor rregullohet në aktet nënligjore që i miraton Këshilli Drejtues i Akademisë.

## **Përgatitja dhe verifikimi i pyetjeve për provimin për drejtor**

### **Neni 22**

(1) Bazat e pyetjeve për pjesën e parë dhe bazat e shembullit praktik për pjesën e dytë të provimit i përgatisin punëtorët shkencor me titull doktor i shkencor me titull doktor i shkencave në jurisprudencë dhe ekonomi, të përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.

(2) Pyetjet e pjesës së parë të provimit dhe pyetjet e shembujve praktikë të pjesës së dytë të provimit i verifikon komisioni, i përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë i përbërë nga:

- një përfaqësues prej Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë,
- një përfaqësues i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës dhe
- tre përfaqësues nga radhët e punëtorëve shkencorë me titull doktor të shkencave nga sfera e jurisprudencës dhe ekonomisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (2) i këtij neni bën edhe revizion dhe azhurnim të bazës së të dhënave dhe bazës së shembujve praktikë për provimin së paku një herë në vit.

(4) Gjatë revizionit komisioni në veçanti i ka parasysh ndryshimet e praktikës dhe standardet në të cilat është bazuar pyetja, përkatësisht shembulli praktik, numrin e kandidatëve që janë përgjigjur, suksesi në përgjigjen për të njëjtat, si dhe kriteret të tjera të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të bazës së të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Në bazë të revizionit të kryer dhe azhurnimit të bazës të pyetjeve dhe bazës së shembujve praktikë, komisioni vendos që pyetjet dhe shembujt praktikë të ndryshohen ose plotësisht të largohen nga bazat e paragrafit (1) të këtij neni.

(6) Punëtorët shkencorë nga paragrafi (1) i këtij neni dhe anëtarët e komisionit për verifikimi të paragrafit (2) të këtij neni kanë të drejtë në kompensim në para që e përcakton Këshilli drejtues i Akademisë.

(7) Shuma e kompensimit në para nga paragrafi (6) i këtij neni përcaktohet në bazë të numrit të pyetjeve të përgatitura dhe shembujve praktikë, si dhe ndërlikueshmëria e materies.

(8) Kompensimi vjetor në para nga paragrafi (6) i këtij neni nuk e tejkalon nivelin e një rrege mesatare të paguar në Republikën e Maqedonisë, në vitin paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës në Republikën e Maqedonisë.



## **Subjektet kompetente për kryerjen e punëve profesionale-administrative edhe përzbatimin teknik të provimit për drejtor**

### **Neni 23**

Punët profesionale dhe administrative për nevojat e realizimit të provimit i bën Akademia, ndërsa provimin teknik e realizon personi juridik i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë i zgjedhur nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

## **Incizimi i dhënies së provimit për drejtor**

### **Neni 24**

(1) Provimi jepet në hapësirë për dhënien e provimit, e pajisur në veçanti për dhënien e provimit me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje të internetit dhe pajisje për incizimin e dhënies së provimit.

(2) Dhënia e provimit incizohet dhe direkt emitohet në ueb faqen e Akademisë, ndërsa nëse për shkak të pengesave teknike incizimi ndërpritet, incizimi i provimit të plotë vendoset në ueb faqen e Akademisë.

(3) Kriteret lidhur me kushtet e hapësirës dhe pajisjen materiale-teknike dhe informatike të hapësirave për dhënien e provimit i përcakton Këshilli drejtues i Akademisë.

(4) Në hapësirën për dhënien e provimit, gjatë kohës së dhënies së provimit, janë të pranishëm pesë përfaqësues prej të cilëve një përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe një përfaqësues nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë dhe një përfaqësues nga Këshilli Drejtues i Akademisë dhe dy përfaqësues nga radhët e informaticientëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.

## **Rregulla të sjelljes gjatë kohës së dhënies së provimit për drejtor**

### **Neni 25**

(1) Para fillimit të dhënies së provimit përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit për Prokurorë Publikë të Republikës së Maqedonisë e përcaktojnë identitetin e kandidatit me kontrollin e letërnjoftimit dhe mban procesverbal për dhënien e provimit.

(2) Kandidati gjatë kohës së dhënies së provimit të pjesës së parë nuk i lejohe shfrytëzimi i literaturës profesionale, telefonit mobil, pajisjes bartëse kompjuterike dhe mjeteve tjera teknike dhe informatike dhe ngjashëm.

(3) Kandidatit gjatë kohës së dhënies së pjesës së dytë të provimit i lejohe shfrytëzimi vetëm i literaturës profesionale e cila shfrytëzohet në versionin elektronik që gjendet në kompjuterin në të cilin kandidati e jep provimin.

(4) Kandidatit gjatë kohës së dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit nuk i lejohe të kontaktojë me kandidatë të tjerë ose persona përpos me informaticientin nga neni 24 paragrafi (4) i këtij ligji, në rast nëse ka probleme teknike me kompjuterin.

(5) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohe për pesë minuta provimi vazhdon, e nëse nuk mënjanohe në këtë afat provimi vetëm për atë kandidat ndërpritet dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditë nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse ka probleme me më shumë se pesë kompjuterë dhe nëse ato nuk mënjanohe në afat prej pesë minutave provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që e japin provimin dhe do të mbahet në afat prej më së shumti tri ditësh nga dita e ndërprerjes së provimit.

(7) Nëse kandidati gjatë dhënies së pjesës së parë dhe të dytë të provimit vepron në kundërshtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni nuk do t'i lejohet dhënia e mëtejme e provimit në atë termin të përcaktuar.

(8) Në rastet e paragrafit (7) të këtij neni llogaritet se kandidati nuk e ka dhënë provimin dhe kjo konstatohet në procesverbal për dhënien e provimit.

(9) Përfaqësuesit e neni 24 paragrafi (4) i këtij ligji gjatë kohës së dhënies së provimit nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të drejtpërdrejtë të kandidatit i cili e jep provimin, përveç në rast të mënjanimi të problemit teknik kur nuk guxojnë të qëndrojnë më gjatë se pesë minuta.

### **Mënyra e përgjigjes së pyetjeve nga provimi për drejtor dhe vendosja e sistemit unik elektronik për dhënien e provimit**

#### **Neni 26**

(1) Dhënia e pjesës së parë të provimit kryhet me përgjigje të një numri të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter.

(2) Pyetje e testit, varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në test.

(3) Dhënia e pjesës së dytë të provimit bëhet me studimin e shembullit praktik dhe përgjigje të një numri të caktuar të pyetjeve të cilat dalin nga shembulli praktik, në formë të zgjidhjes elektronike softuerike (në tekstin e mëtejme: shembull praktik).

(4) Pyetjet e shembullit praktik, varësisht nga pesha, vlerësohen me pikë të përcaktuara në shembullin praktik.

(5) Pyetjet e përmbajtura në testet për dhënien e pjesës së parë të provimit dhe përgjigjet e tyre, si dhe shembullin praktik të pyetjeve të cilat dalin nga shembujt praktikë dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin unik elektronik për dhënien e provimit, të cilin e vendos Këshilli drejtues i Akademisë.

(6) Sistemi elektronik nga paragrafi (5) i këtij neni përmban edhe bazë të arritshme publike prej së paku 300 pyetje për pjesën e parë të provimit, si dhe bazë të arritshme publike prej së paku 50 shembujve praktikë për pjesën e dytë të provimit.

(7) Në sistemin elektronik të paragrafit (5) të këtij neni është përmbajtur udhëzimi për literaturën profesionale nga e cila dalin përgjigjet e pyetjeve të provimit.

(8) Numri i pyetjeve dhe shembujve praktikë në bazat e paragrafit (6) të këtij neni rritet për 10% në vit, duke filluar nga viti 2016.

(9) Rezultatet nga dhënia e provimit të pjesës së parë dhe të dytë të provimit janë të arritshme për kandidatin në kompjuter në të cilin e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

### **Mënyra e dhënies së provimit për drejtor**

#### **Neni 27**

(1) Në ditën e dhënies së provimit të pjesë së parë, përkatësisht pjesës së dytë të provimit përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit për Prokurorë Publikë të Republikës së Maqedonisë i japin kandidatit kod qasës, përkatësisht fjalëkalim me të cilin miratohet qasja në sistemin elektronik në nenin 26 të këtij ligji.

(2) Pas miratimit të qasjes kandidati merr test elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembull praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit, të gjeneruara me kompjuter, përmbajtjen e të cilave me zgjedhje të rastësishme e përcakton softueri i sistemit elektronik nga neni 26 të këtij ligji.

(3) Pjesa e parë dhe e dytë e provimit përmbajë udhëzim për mënyrën e zgjidhjes së të njëjtit, për të cilin përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të

Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë japin sqarim, para se të fillojë dhënia e provimit.

(4) Sistemi elektronik nga neni 26 i këtij ligji nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për pjesën e parë të provimit, përkatësisht shembullit praktik elektronik për pjesën e dytë të provimit në një termin për më shumë se një kandidat.

### **Ndërprerja, vazhdimi dhe ricaktimi i dhënies së provimit për drejtor**

#### **Neni 28**

(1) Në rast të pengimit të zbatimit të pjesës së parë dhe të dytë të provimit, për shkaqe që sjellin në pamundësi teknike të funksionimit të sistemit elektronik nga neni 26 paragrafi (5) i këtij Ligji, dhënia e provimit ndërpritet.

(2) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni mënjanohen në afat prej 60 minutave nga ndërprerja e provimit i njëjti vazhdon menjëherë pas mënjanimit të tyre.

(3) Nëse shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mënjanohen në afatin nga paragrafi (2) i këtij neni provimi ricaktohet për termin tjetër.

### **Kohëzgjatja e pjesës së parë dhe të dytë të provimit për drejtor dhe dhënia me sukses e provimit për drejtor**

#### **Neni 29**

(1) Kohëzgjatja e plotë e kohës së përcaktuar për dhënien e përgjigjeve nga pjesa e parë e testit për dhënien e provimit është 90 minuta.

(2) Llogaritet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të testit ka arritur së paku 70% nga numri i plotë i pikëve të parapara pozitive.

(3) Kohëzgjatja e plotë e kohës së përcaktuar për dhënien e përgjigjeve nga shembulli praktik i pjesës së dytë është 90 minuta.

(4) Llogaritet se provimin e ka dhënë ai kandidat i cili me përgjigje të sakta të pyetjeve të shembullit praktik ka arritur së paku 70% nga numri i plotë i pikëve të parapara pozitive.

### **Informimi për gabimet e bëra në testin për dhënien e provimit për drejtor**

#### **Neni 30**

Me kërkesë të kandidatit Këshilli Drejtues i Akademisë e informon për gabimet e bëra në testin për dhënien e provimit, me mundësimin e shikimit direkt të testit.

### **Komisioni për revizion të provimeve të mbajtura për drejtor**

#### **Neni 31**

(1) Testet dhe shembujt praktikë shfrytëzohen dhe i jepen kandidatit vetëm gjatë kohës së dhënies së provimit.

(2) Materialet e provimeve të mbajtura, në veçanti versionet në letër nga testet dhe shembujt praktikë për dhënien e provimit dhe specimenet për kontrollin e saktësisë së përgjigjeve të testit dhe shembullit praktik, si dhe incizimet për provimet e mbajtura ruhen në Akademi.

(3) Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë formojnë komision për revizionin e provimeve të mbajtura, i cili në punën e vet e shfrytëzon materialin nga paragrafi (2) i këtij neni dhe në të cilin anëtarësojnë edhe përfaqësues të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.

(4) Komisioni nga paragrafi (3) i këtij neni mblidhet së paku një herë në vit dhe bën revizion të mënyrës së zbatimit të së paku dy provimeve të mbajtura në vitin rrjedhës.

### **Të drejtat dhe detyrimet e drejtorit**

#### **Neni 32**

Drejtori i ka këto të drejta dhe detyrime:

- udhëheq me punën e Akademisë,
- e përfaqëson dhe prezanton Akademinë para institucioneve vendase dhe ndërkombëtare,
- i zbaton vendimet e Këshillit Drejtues.
- e koordinon dhe organizon punën e Akademisë,
- kujdeset për sigurinë e kushteve për funksionimin e përditshëm të Akademisë,
- në Këshillin Drejtues parashtron propozim-program për punën e Akademisë,
- në Këshillin Drejtues parashtron raport vjetor për punën e Akademisë,
- merr pjesë në përgatitjen e të gjitha programeve për trajnim në kompetencë të Akademisë,
- merr pjesë në punën e Këshillit Drejtues dhe kryeson me mbledhjet e Këshillit programor,
- propozon listë të ligjëruesve,
- vendos dhe mban bashkëpunim me institucionet e ngjashme vendase dhe të huaja për avancimin e trajnimit,
- udhëheq me shërbimin për punë profesionale, administrative-teknike dhe ndihmëse të Akademisë,
- menaxhon me mjete financiare dhe me pronën e Akademisë,
- propozon ndryshime dhe plotësime të Statutit dhe akteve tjera të përgjithshme të Akademisë,
- përgjigjet për ligjshmërinë e punës së Akademisë dhe
- kryen edhe punë tjera në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

#### **Neni 33**

(1) Rroga e drejtorit përcaktohet në nivelin e rrogës së gjykatësit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht prokurorit publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë, të përcaktuar me ligj.

(2) Rroga e zëvendës-drejtorit përcaktohet në nivelin e rrogës së gjykatësit në gjykatën e apelit, përkatësisht prokurorit publik në prokurorinë e lartë publike, të përcaktuar me ligj.

### **Mandati i drejtorit dhe zëvendës-drejtorit**

#### **Neni 34**

Drejtori dhe zëvendës-drejtori emërohen në kohë prej katër vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes.

### **Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i drejtorit dhe zëvendës-drejtorit**

#### **Neni 35**

(1) Drejtorit dhe zëvendës-drejtorit i ndërpritet mandati para skadimit të kohës për të cilin janë emëruar:

- për shkak të vdekjes,
- me kërkesë të tij,
- nëse është përcaktuar paaftësi permanente për punë dhe
- nëse i plotëson kushtet për pensionim.

(2) Drejtori dhe zëvendës-drejtori shkarkohet para skadimit të mandatit për të cilin janë emëruar:

- për shkak të kryerjes së funksionit në mënyrë joprofessionale dhe të pandërgjegjshme.

-nëse me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

-nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj.

(3) Kundër vendimit të Këshillit Drejtues për shkarkimin e drejtorit, përkatësisht zëvendësdrejtorit, drejtori, përkatësisht zëvendësdrejtori ka të drejtë në kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(4) Deri në emërimin e drejtorit të ri Këshilli Drejtues do të përcaktojë ushtrues të detyrës drejtor nga radhët e anëtarëve të Këshillit Drejtues.

### **Këshilli programor**

#### **Neni 36**

(1) Këshilli programor është organ profesional i Akademisë.

(2) Këshilli programor është i përbërë nga shtatë anëtarë dhe zëvendës të tyre të cilët i emëron Këshilli drejtues nga radhët e gjykatësve, prokurorëve publikë, nëpunësve udhëheqës shtetërorë nga Ministria e Drejtësisë, si dhe juristë të tjerë të shquar nga mendimi juridik shkencor dhe hulumtues në sferën e jurisprudencës.

#### **Neni 37**

(1) Për anëtar dhe zëvendës i tij në Këshillin programor mund të emërohet:

-gjykatës aktiv ose prokuror publik me së paku gjashtë vjet përvojë pune si gjykatës ose prokuror publik,

-profesor ordinar ose inordinar i shkencave juridike ose juristë të theksuar me titull akademik doktor të shkencave me së paku gjashtë vjet përvojë pune në sferën juridike të përcaktuar dhe

-nëpunës udhëheqës shtetëror nga Ministria e Drejtësisë me së paku katër vjet përvojë pune në punë nga sfera e jurisprudencës.

(2) Anëtarët dhe zëvendësit e tyre të Këshillit Programor duhet të posedojnë kualitete të larta profesionale dhe prestigj në kryerjen e funksionit dhe profesionit, të cilët kanë rezultate të konfirmuara në punë, të punimeve, të shkrimeve dhe të kenë përvojë në punën mësimore dhe të mentorit lidhur me sferën e jurisprudencës.

(3) Mandati i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të Këshillit Programor zgjatë dy vjet, me të drejtë të rizgjedhjes.

(4) Anëtarët dhe zëvendësit e tyre të Këshillit Programor nuk mund të jenë anëtarë dhe zëvendës të tyre të Këshillit Drejtues të Akademisë, Komisionit për provim pranues dhe Komisionit për provim përfundimtar.

(5) Anëtarët dhe zëvendësit e tyre të Këshillit programor mund të jenë ligjërues në Akademi.

(6) Për anëtar përkatësisht zëvendësanëtar i Këshillit Programor mund të emërohet personi i cili detyrimisht duhet në mënyrë aktive ta njohë një nga gjuhët e Bashkimit Evropian, prej të cilëve detyrimisht gjuhën angleze që dëshmohet me posedimin e certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht të lëshuar nga tetstatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropianë të B2 (B2) nivelit të CEFR (CEFR), përkatësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK B, IKFE, BULAS ose Aptis, ose TOEFEL PBT së paku 500 pikë, TOEFEL CBT së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete, TestDaF.

(7) Anëtari përkatësisht zëvendësanëtari i Këshillit programor duhet të posedojnë integritet për kryerjen e funksionit, për çfarë zbatohen teste për integritet dhe teste psikologjike, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### Neni 38

(1) Anëtarët e Këshillit Programor dhe zëvendësit e tyre i emëron Këshilli Drejtues në bazë të nominimeve nga ana e institucioneve të përfaqësuara në Këshillin Drejtues të Akademisë. Nominimet e kandidatëve dorëzohen në Akademi me biografinë.

(2) Nominimi i anëtarëve dhe zëvendësve të tyre të Këshillit Programor bëhet në këtë mënyrë:

-Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë në mbledhjen e përgjithshme nominon dy anëtarë dhe zëvendës të tyre dhe atë njëri anëtar dhe zëvendësi i tij nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, ndërsa anëtari tjetër dhe zëvendësi i tij nga radhët e gjykatësve në gjykatat më të ulëta ose Gjykata Administrative përkatësisht Gjykata e Lartë Administrative,

- Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë nominon dy anëtarë dhe zëvendës të tyre nga radhët e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë dhe atë një anëtar dhe zëvendësi i tij nga radhët e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, ndërsa anëtari i dytë dhe zëvendësi i tij nga radhët e prokurorive publike më të ulëta të Republikës së Maqedonisë,

- Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë nominon një anëtarë dhe zëvendësin e tij nga radhët e anëtarëve të vet,

- Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë nominon një anëtar dhe zëvendësin e tij nga radhët e anëtarëve të vet dhe

- ministri i Drejtësisë nominon një anëtarë dhe zëvendës të tij nga radhët e nëpunësve udhëheqës administrativë në Ministrinë e Drejtësisë.

### Neni 39

(1) Këshilli Programor i Akademisë:

- përcakton propozim-programin për provim pranues,
- përcakton propozim-programin për trajnim fillestar,
- përcakton propozim-programin për provim përfundimtar,
- përcakton propozim-programin për trajnim të vazhdueshëm, propozim-programin për praktikim të funksionit të gjyqtarit dhe të prokurorit publik dhe programe tjera të specializuara,
- e përcjell realizimin e programeve dhe efikasitetin e tyre dhe suksesin,
- i përtërin dhe i zhvillon programet për trajnim, në varësi nga analiza vjetore e nevojave për trajnim, evaluimi i kryer, propozimet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve në trajnime, ligjëruesit dhe mentorët, si dhe legjislacioni dhe praktika vendore dhe ndërkombëtare,
- jep udhëzime për avancimin e metodave mësimore dhe teknikave në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me ligjëruesit dhe mentorët,
- jep mendim për listën e ligjëruesve,
- kryen verifikimin e bazave të pyetjeve dhe bazave të studimeve të rastit, të përpiluara nga ana e ligjëruesve për zbatimin e provimit pranues dhe përfundimtar në Akademi.
- u jep këshilla, propozime dhe sugjerime organeve të Akademisë për përmirësim të kualitetit të mësimit dhe
- kryen punë tjera në pajtim me këtë ligj, Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

(2) Gjatë përcaktimit të propozim-programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, Këshilli Programor udhëhiqet, krahas nga rregullat pozitive në Republikën Maqedonisë edhe nga e drejta ndërkombëtare, e drejta e Bashkimit Evropian, praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe gjykatat tjera ndërkombëtare.

### **Ndërprerja e mandatit dhe shkarkimi i anëtarit të Këshillit Programor**

### Neni 40

(1) Anëtarit dhe zëvendësanëtarit të Këshillit Programor i ndërpritet mandati:

-me kërkesë të tij,

-për shkak të vdekjes,  
-nëse i ndërpritet funksioni ose marrëdhënia e punës në organin ku e ka kryer funksionin ose ka themeluar marrëdhënie të punës dhe

-nëse është i penguar ta kryejë funksionin anëtar ose zëvendësanëtar i Këshillit Programor më gjatë se gjashtë muaj për shkak të sëmundjes ose shkaqeve tjera të arsyeshme.

(2) Anëtarit dhe zëvendësanëtarit i Këshillit Programor shkarkohet për shkak të:

-kryerjes joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të funksionit në Këshillin Programor,  
-nëse me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar masë ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

-nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) ose (2) të këtij neni, organi i cili e ka nominuar anëtarin, përkatësisht zëvendës-anëtarin, i cili është shkarkuar ose mandati i të cilit është ndërprerë, nominon anëtar të ri, përkatësisht zëvendësanëtar, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit për shkarkim, përkatësisht ndërprerje të mandatit.

(4) Mandati i anëtarit të sapoemëruar, përkatësisht zëvendës-anëtarit të Këshillit Programor zgjat deri në përfundim të mandatit për të cilin anëtarët e Këshillit Programor janë emëruar.

(5) Deri në emërimin e anëtarit të ri të Këshillit Programor punën e anëtarit e kryen zëvendësanëtarit.

### **Kompensimi i shpenzimeve të anëtarëve të Këshillit Programor**

#### **Neni 41**

(1) Anëtarët e Këshillit Programor ka të drejtë në kompensim për punën e kryer, si dhe të drejtë të kompensimit të shpenzimeve rrugore dhe ditore, në pajtim me rregullat me të cilat rregullohen ato çështje.

(2) Kompensimin nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton Këshilli Drejtues i Akademisë në bazë të vëllimit të detyrave të kryera të punës, ndërlikueshmëria e tyre, si dhe shpenzimet e rrugës dhe ditore të përcaktuara në pajtim me rregullat pozitive ligjore.

### **Mënyra e punës së Këshillit Programor**

#### **Neni 42**

(1) Mbledhjet e Këshillit Programor i cakton dhe me to udhëheq drejtori i Akademisë.

(2) Në mbledhjet e Këshillit Programor mund të jenë të pranishëm ligjëruesit dhe mentorët, si dhe persona tjerë të cilët me njohuritë e tyre profesionale, kompetente dhe përvojat mund të japin kontribut për përmirësimin e mësimin në Akademi.

## **III. LIGJËRUES**

### **Nocioni për ligjërues**

#### **Neni 43**

(1) Ligjëruesit janë persona profesionalë për zbatimin e programeve për trajnim në Akademi.

(2) Për ligjërues në Akademi angazhohen persona të cilët me aktivitetet e tyre gjatë zbatimit të drejtpërdrejtë të programeve për trajnim, japin kontribut për mbajtjen e nivelit të lartë të njohurive dhe shkathtësive të gjykatësve, prokurorëve publikë, si dhe subjekteve nga neni 1 i këtij ligji, në pajtim me legjislacionin e vendit dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

(3) Ligjëruesit mund të jenë ligjërues në Akademi dhe ligjërues sipas nevojës.

(4) Мënyра е пërpilimit, numri, mandati dhe пërbërja e propozim-listës të ligjëruesve, kompensimet, si dhe kriteret më të afërta për evaluim të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm, rregullohet me Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë, në pajtim me parimet e transparencës, profesionalitetit dhe qasjes së barabartë.

(5) Të drejtat dhe detyrimet e ligjëruesve rregullohen me marrëveshje të lidhur ndërmjet tyre dhe Akademisë, në pajtim me Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

### **Ligjërues në Akademi**

#### **Neni 44**

(1) Ligjërues në Akademi janë gjykatës të vendit dhe të huaj dhe prokuror publikë, avokatë dhe profesorë universitarë, të cilët angazhohen në programet për trajnim fillestar dhe programet për trajnim të vazhdueshëm në Akademi, noterë, ndërmjetës, përmbarues dhe nëpunës udhëheqës administrativë.

(2) Ligjërues në Akademinë nga paragrafi (1) i këtij neni nga radhët e gjykatësve të vendit dhe prokurorëve publikë, avokatëve, noterëve, ndërmjetësve, përmbaruesve dhe nëpunësve udhëheqës administrativë mund të jenë persona të cilët kanë mbaruar trajnim për trening të ligjëruesve (trajnuës) të organizuar nga Akademia.

(3) Nëse ligjëruesi refuzon ta zbatojë trajnimin, shlyhet nga lista e ligjëruesve.

#### **Neni 45**

(1) Ligjëruesit të Akademisë caktohen nga radhët të gjykatësve dhe prokurorëve publikë, avokatë pse profesorë universitar me gjashtë vjet përvojë pune si gjykatës ose prokuror publik.

(2) Ligjërues në sferën e trajnimit të vazhdueshëm mund të jenë edhe anëtarët e Bordit Drejtues, Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë dhe drejtori i Akademisë, pa kompensim.

(3) Personat nga paragrafi (2) i këtij neni mund t'u mbajnë ligjërata edhe dëgjuesve në trajnim fillestar, por pa kompensim dhe të drejtë t'i vlerësojnë dëgjuesit, në pajtim me aktet të përgjithshme me të cilat rregullohet zbatimi i trajnimit fillestar.

(4) Si ligjërues në trajnim fillestar nuk mund të jenë të zgjedhur anëtarët e Bordit Drejtues dhe zëvendësit e tyre, anëtarët e Komisionit për Provim Pranues dhe zëvendësit e tyre, anëtarët e Komisionit për Verifikim, si dhe anëtarët e Komisionit për Provim Përfundimtar dhe zëvendësit e tyre.

(5) Ligjëruesit në mënyrë të obligueshme duhet që aktivisht të njohin një nga gjuhët oficiale të Unionit Evropian, prej të cilave në mënyrë të obligueshme gjuhën angleze që dëshmohet me posedimin e certifikatës ndërkombëtarisht të pranuar të dhënë nga testues oficial evropian, anëtar i shoqërisë ALTE të testuesve evropianë të nivelit B1 (B1) të CEFR (CEFR), përkatësisht IELTS me 3,5 – 4,5 pikë, PET, BEK P, BULATS, ose Aptis, ose TOEFEL PBT më së paku 450 pikë, TOEFEL CBT së paku 135 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 45 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose Gëte certifikatë.

### **Ligjërues sipas nevojës**

#### **Neni 46**

(1) Ligjërues sipas nevojës janë personat profesionalë të cilët angazhohen për trajnim të veçantë ose cikël të trajnimeve, në sfera dhe tema të caktuara juridike, si dhe për trajnime në sfera të përgjithshme komplementare dhe jojuridike dhe tema nga radhët e personave të theksuar profesionalë në sferën përkatëse për të cilën janë angazhuar, mjekësi, teknologji kompjuterike, gjuhë të huaja, sociologji, shkenca të komunikimit, ekonomi, psikologji dhe shkenca tjera, të lidhura me temat nga programet për trajnim.



Listën e ligjëruesve sipas nevojës të angazhuar gjatë vitit,

(3) drejtori është i obliguar ta dorëzojë në njohje të Bordit Drejtues, së bashku me biografi dhe evalvim për trajnimin e zbatuar nga ana e tyre.

(4) Për përpilimin e temave të reja të caktuara dhe programeve pas propozimi të arsyetuar të drejtorit, lista mund të zgjerohet me ligjërues të rinjë në numër të caktuar nga ana e Bordit Drejtues.

(5) Për ligjëruesit sipas nevojës vlejnjë kushte të përcaktuara nga neni 45 i këtij Ligji.

#### Neni 47

Për përpilimin dhe për zbatimin e programeve për mësim përgatitor për provimin pranues, në programin për provim pranues, në programet për trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm ligjëruesve u paguhet kompensim në lartësi të caktuar me vendim të Bordit Drejtues.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet në varësi nga orët e realizuara mësimore, vëllimi i materialeve të përpiluara për trajnim, vëllimi i kontrollit të zbatuar të dijenive të mara nga trajnimi dhe të ngjashme.

### IV. MENTORËT

#### Neni 48

(1) Mentorë, në pajtim me këtë ligj, mund të jenë vetëm gjykatës aktivë dhe prokurorë publikë, me së paku gjashtë vjet përvojë pune, në mënyrë të vazhdueshme të vlerësuar me notë pozitive nga ana organit i cili e përcjell dhe vlerëson punën e tyre, me aftësi dhe përgatitje për bartje të përvojave dhe dijenive, ndërsa të cilët e zbatojnë fazën e dytë të trajnimit fillestar - mësimin praktik.

(2) Mentorët në propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë i përcakton Bordi Drejtues. Për mentorë nuk mund të zgjidhen anëtarët dhe zëvendësit e Bordit Drejtues, Këshillit Programor, Komisionit për Provim Pranues, Komisionit për Provim Përfundimtar, kryetari dhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, kryetarët e gjykatave dhe prokurorët publikë të prokurorive publike në Republikën e Maqedonisë.

(3) Kushtet më të afërta për zgjedhjen, kohëzgjatja e mentorimit, të drejtat dhe detyrimet dhe kompensimit të mentorëve rregullohen me Statut dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

(4) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (4) i këtij neni caktohet në varësi nga numri i kandidatëve të mentoruar dhe kohëzgjatja e stazhit të tyre të mentorimit.

(5) Mentorë mund të jenë personat të cilët krahas kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni kanë përfunduar trajnim për ushtrim të mentorëve (trajnuet) të organizuar nga Akademia.

### V. SHËRBIMI PËR PUNË NDIHMËSE-TEKNIKE PROFESIONALE I AKADEMISË

#### Neni 49

(1) Të punësuarit në Akademi kanë status të nëpunësve administrativë dhe në lidhje me të drejtat e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë zbatohet Ligji për nëpunës administrativë.

(2) Të punësuarit të cilët kryejnë punë ndihmëse ose teknike nuk kanë status të nëpunësve administrativë dhe në lidhje me të drejtat të tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë zbatohet neni 3 i Ligjit për të punësuar në sektorin publik.

## VI. FINANCIMI DHE MJETE PËR PUNË TË AKADEMISË

### Burime të financimit

#### Neni 50

(1) Mjetet për punë të Akademisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë nëpërmjet buxhetit të "Pushtetit Gjyqësor".

(2) Burime tjera të financimit janë:

- donacione dhe dhurata dhe
- të hyra individuale dhe të hyra nëpërmjet dhënies së publikimeve, realizimi i trajnimeve për grupe tjera të interesit të cilat janë jashtë nga sfera e jurisprudencës dhe në jurisprudencë, realizimi i projekteve, grante, të cilat nuk janë në kundërshtim me veprimtarinë e Akademisë, ndërsa në pajtim me Bordin Drejtues.

#### Neni 51

Mjetet buxhetore nga neni 50 paragrafi (1) të këtij ligji sigurohen në lartësi që të mbulohen organizimi dhe zbatimi i provimit pranues dhe përfundimtar, trajnimi fillestar dhe trajnimi i obligueshëm në vazhdimësi, në pajtim me këtë ligj.

### Lokalet dhe pajisjet

#### Neni 52

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë i siguron lokalet dhe pajisjet për kryerjen e veprimtarisë së Akademisë.

(2) Akademia mund të sigurojë mjete për pajisje dhe lokale dhe me donacione dhe grante në pajtim me Këshillin Drejtues.

## VII. TRAJNIMI I GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË

### Nocioni dhe qëllimi

#### Neni 53

Trajnimi i gjykatësve dhe prokurorëve publikë paraqet aftësi të organizuar dhe përsosje të njohurive praktike dhe teorike dhe aftësitë e nevojshme për kryerjen e funksionit të pavarur, të mëvetësishëm, profesional dhe efikas.

### Llojet e trajnimit

#### Neni 54

Akademia organizon trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm.

### 1. Trajnimi fillestar

#### Neni 55

Trajnimi fillestar organizohet për marrjen e njohurive praktike dhe teorike dhe aftësi, me qëllim për krijimin e kandidatëve me trajnim të lartë, profesional dhe efikas të gjykatësve dhe prokurorëve publikë në gjykatat themelore dhe prokuroritë publike themelore, si parakusht për respektimin e principit të sundimit të të drejtës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, liritë dhe krijimin e drejtësisë kualitative në interes të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

## **Dëgjues të trajnimit fillestar**

### **Neni 56**

(1) Dëgjuesit e trajnimit fillestar janë persona të cilët e kanë kaluar provimin pranues dhe janë pranuar në trajnimin fillestar.

(2) Numri i përgjithshëm i dëgjuesve të trajnimit fillestar përcaktohet në bazë të vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, duke pasur parasysh numrin e vendeve të lira për gjykatës dhe prokurorë publikë në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike, si dhe projekcioni për nevojat nga vendet të cilat do të plotësohen pas mbarimit të trajnimit fillestar.

(3) Vendimet nga paragrafi (2) i këtij neni të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë dorëzohen te Akademia më së voni deri në 31 mars në vitin në të cilën Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë me vendimet nga paragrafi (2) i këtij neni e kanë përcaktuar numrin e dëgjuesve të trajnimit fillestar.

## **Kushtet për pranim në trajnimin fillestar**

### **Neni 57**

(1) Kushtet për pranim në trajnimin fillestar janë:

- jurist i diplomuar me mbarim të arsimit të lartë katërvjeçar shkallën VII/1 të studimeve juridike me mesatare nga më së paku 8,0 dhe studime pasdiplomike me mesatare së paku 8,0 ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (SETK), me mesatare së paku 8,0 në secilin nga dy ciklet e studimeve universitare,

- provimin e jurisprudencës së kaluar,  
- përvojë pune nga më së paku dy vite në punë juridike për provim të kaluar të jurisprudencës,  
- të mos i jetë shqiptuar masa e sigurisë ndalesë e kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,

- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase,

- në mënyrë aktive të njohë një nga gjuhët oficiale të Bashkimit Evropian, nga të cilat detyrimisht gjuhën angleze që dëshmohet me certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht nga testatorët evropianë oficiale, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian në nivelin B2 (B2) të CEFR (CEFR), respektivisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK B, ILEK, IKFE, BULATS, ose Aptis, ose TOEFEL PBT më së paku 500 pikë, TOEFEL CBT më së paku 175 pikë, ose TOEFEL IBT më së paku 60 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose Gete certifikatë, Test DaF

- punë praktike me kompjuter dhe

- të jetë i aftë për punë dhe të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore.

(2) Llojin, mënyrën dhe kushtet e përafërta për kryerjen e kontrolleve shëndetësore dhe niveli i punës praktike me kompjuter nga paragrafi (1) alineja 8 dhe 9 nga ky nen i rregullon Këshilli Drejtues i Akademisë.

## **Shpallja publike për pranim në trajnim fillestar**

### **Neni 58**

(1) Këshilli Drejtues miraton vendim për publikim të shpalljes publike për pranim të personave për dhënien e provimit pranues në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit nga neni 56 paragrafi (2) të këtij ligji në Akademi.

(2) Shpallja publike shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në së paku dy gazeta ditore nga të cilat një nga gazetat të cilat botohen në gjuhën maqedonase dhe një

nga gazetat të cilat botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% nga qytetarët që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

(3) Afati për paraqitjen e personave të shpalljes publike është 15 ditë, duke llogaritur nga dita e botimit të saj në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

### **Mënyra e paraqitjes**

#### **Neni 59**

(1) Çdo kandidat i te Akademia paraqet fletëparaqitje, në formular të përgatitur nga Akademia, në të cilën përmbahen të dhëna për plotësimin e kushteve për pranim sipas shpalljes publike.

(2) Në formularin e fletëparaqitjes nga paragrafi 1 i këtij neni janë përmbajtur të dhënat në vijim:

- Të dhëna personale dhe NUAQ;
- Të dhënat e përafërta për plotësimin e kushteve për pranim dhe dokumentet e nevojshme, në pajtim me shpalljen publike.

(3) Kandidatët e interesuar mund ta marrin formularin e fletëparaqitjes nga internet faqja e Akademisë.

(4) Fletëparaqitjen me dokumentacionin e nevojshëm parashtruesi personalisht i parashtron te personi i autorizuar për pranimin me shkrim në Akademi dhe me këtë rast çdo kandidat merr shifër të provimit.

#### **Neni 60**

(1) Personi i autorizuar për pranimin e fletëparaqitjes në Akademi është i obliguar t'i pranojë të gjitha fletëparaqitjet me dokumente të dorëzuara, kurse në kohë dhe rregullshmërinë e paraqitjeve i vlerëson Komisioni për Provim Pranues.

(2) Komisioni për Provim Pranues me vendim do t'i hedhë poshtë fletëparaqitjet me vonesë dhe jo të kompletuara dhe ekzemplar nga vendimi do të dorëzohet te parashtruesi i fletëparaqitjes.

(3) Parashtruesi i fletëparaqitjes në afat prej tri ditësh nga pranimi i vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni ka të drejtë në ankesë te Këshilli Drejtues i Akademisë.

(4) Këshilli Drejtues vendimin për ankesën e miraton në afat prej 3 ditësh.

### **Parimet e pranimit në trajnimin fillestar**

#### **Neni 61**

(1) Pranimi në trajnimin fillestar është i arritshëm për secilin që i plotëson kushtet për pranim të përcaktuara me këtë ligj, Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë dhe i cili me sukses e ka kaluar provimin pranues në një nga sesionet pyetëse.

(2) Procedura për organizimin dhe dhënien e provimit pranues bazohet në parimin e transparencës në rregulla, metodat dhe mënyra e zbatimit, vlerësimi dhe publikimi i rezultatit, si dhe puna e Komisionit për pranim në trajnimin fillestar, bazuar në kritere objektive dhe publike të cilat sigurojnë pavarësi, objektivitet, si dhe qasje të lirë te programi për provim pranues.

## **2. Provimi pranues për trajnim fillestar**

### **Qëllimi i provimit pranues**

#### Neni 62

Qëllimi i provimit pranues është përcaktimi i shkallës së njohurive profesionale, ndjekje e nevojshme e programit për trajnim fillestar.

### **Mësimi përgatitor**

#### Neni 63

(1) Akademia organizon mësim përgatitor për të gjithë personat e paraqitur për pranim në Akademi së paku një herë ose më shumë herë gjatë vitit.

(2) Mësimi përgatitor organizohet së paku 45 ditë para ditës së mbajtjes së provimit pranues.

### **Provimi pranues**

#### Neni 64

Provimi pranues për trajnim fillestar organizohet më së voni deri më 30 shtator të vitit në të cilin Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, duke pasur parasysh numrin e vendeve të lira për gjykatës dhe prokuror publik në gjykatat themelore dhe prokuroritë themelore publike, si dhe projeksioni për nevojat nga vendet e cilat do të plotësohen pas mbarimit të trajnimit fillestar, kanë marrë vendime dhe e kanë përcaktuar numrin e përgjithshëm të dëgjuesve të trajnimit fillestar dhe përbëhet nga dhënia e:

- testit kualifikues,
- testit psikologjik,
- testit për integritet dhe
- provimit.

### **Qëllime themelore dhe principe të provimit pranues**

#### Neni 65

(1) Testi kualifikues është anonim dhe jepet me shkrim në formë elektronike me përgjigjen e numrit të caktuar të pyetjeve në lloj të zgjedhjes së testit elektronik në kompjuter, kurse ka për qëllim në rrugë të kontrollit të njohurive të kandidatit të paraqitur të të drejtës materiale dhe procedurale, të drejtës ndërkombëtare, të drejtat e Bashkimit Evropian dhe aktgjykimet më të rëndësishme të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut t'i përzgjedhë kandidatët sipas kualitetit, të përcaktuar si minimum njohuri për ndjekjen e programit për trajnim fillestar. Anonimitet në testin kualifikues sigurohet me shifrim të kompjuterit.

(2) Testi psikologjik ka për qëllim nëpërmjet kontrollit të aftësive sociale t'i afirmojë kandidatët për kryerjen e funksionit gjykatës dhe të prokurorit publik.

(3) Testi për integritet bazohet mbi kodekset ekzistuese etike dhe profesionale për kryerjen e funksionit gjykatës ose prokuror publik dhe ka për qëllim kontrollin e vlerave etike dhe morale të kandidatit për kryerjen e funksionit gjykatës ose prokuror publik dhe përbëhet nga:

- testi i cili zbatohet me shkrim dhe në mënyrë anonime, në bazë të listës së përcaktuar standarde të pyetjeve dhe
- pjesë përbërëse e testit për integritet dhe kontroll të vetëvlerësimit (seli assessment), me qëllim për kontroll të vlerësimit real të kandidatit me gjendje konkrete.

(4) Provimi ka për qëllim kontroll të njohurive juridike të tërësishme dhe aftësinë e kandidatit për pranim dhe rikujtim të programit për trajnim fillestar, kurse përbëhet nga:

- pjesa praktike dhe
- pjesa verbale.

(5) Akademia është e obliguar të zbatojë provim pranues, kurse aftësimi gjatë zbatimit të testeve psikologjike dhe testit për integritet që të kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale, reputacionin dhe dinjitetin e kandidatëve, në pajtim me ligjin.

### **Procedura për dhënien e provimit pranues**

#### **Neni 66**

(1) Procedura për dhënien e provimit pranues organizohet në Akademi, në pajtim me Programin për provim pranues në të cilën publikohet më së shumti tre muaj para dhënies së provimit pranues dhe përsëritet sipas nevojës, në pajtim me ndryshimet në legjislacion.

(2) Mënyra dhe kushtet e përafërta për dhënien provimit pranues nga neni 64 i këtij ligji, si dhe të drejtat dhe obligimet e personave të cilët e japin provimin pranues rregullohet me Statut dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

(3) Kandidati i pakënaqur nga rezultatet e arritura të testit kualifikues dhe provimi ka të drejtë të ankesës te Komisioni nga neni 67 i këtij ligji në afat prej tri ditësh nga dita e publikimit të rezultateve nga testi kualifikues dhe provimi në ueb faqen dhe tabelën e njoftimeve të Akademisë. Komisioni nga neni 67 i këtij ligji është i obliguar për ankesën të vendosë në afat prej dy ditëve llogaritur nga dita e pranimit të ankesës. Kundër vendimit të Komisionit nga neni 67 i këtij ligji kandidati ka të drejtë në ankesë te Këshilli Drejtues në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(4) Këshilli Drejtues vendimin për ankesën e miraton në afat prej tri ditësh duke llogaritur nga kalimi i afatit për miratimin e ankesës kundër vendimit të Komisionit nga neni 67 i këtij ligji.

(5) Kundër rezultatit nga testi psikologjik dhe testi për integritet nuk lejohet ankesë e veçantë.

### **Komisioni për provim pranues**

#### **Neni 67**

(1) Provimi pranues jepet para Komisionit për Provim Pranues (në tekstin e më poshtëm: Komisioni).

(2) Komisioni është përbërë nga kryetari dhe nëntë anëtarë dhe zëvendës të tyre me mandat prej dy sesioneve pyetëse.

(3) Këshilli Drejtues e zgjedh dhe konstaton Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni në përbërje: katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radhët e gjykatësve, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre me propozim të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë nga radhët e Prokurorëve Publikë, një anëtar dhe zëvendës i tij nga Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, një anëtar dhe zëvendës i tij nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, një anëtar dhe zëvendës i tij me propozim të ministrit të Drejtësisë nga radhët e nëpunësve administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë dhe një anëtar dhe zëvendësi i tij person profesional - psikolog.

(4) Për kryetar, anëtar dhe zëvendës të tyre të Komisionit mund të jenë të zgjedhur gjykatës dhe prokurorë publikë, si dhe nëpunës administrativë udhëheqës në Ministrinë e Drejtësisë të cilët me karrierën e deritanishme profesionale dallohen me profesionalitetin e tyre, etikën, rezultatet e dëshmuara në punë dhe të cilët gëzojnë reputacion të lartë në jurisprudencë.

(5) Kryetarin e Komisionit, Këshilli Drejtues e zgjedh nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

(6) Anëtarët dhe zëvendësit e Këshillit Drejtues, Këshillit të Programit, Komisionit për Provimin Përfundimtar, drejtori i Akademisë, si dhe ligjëruesit dhe mentorët të cilët në atë periudhë janë angazhuar në trajnimin fillestar, nuk mund të jenë anëtar të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Anëtar i Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë kryetari, as anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ose Këshilli i Prokurorëve Publik të Republikës së Maqedonisë, ministri, respektivisht zëvendësministri i Drejtësisë.

(8) Për zbatimin e testit psikologjik Akademia angazhim persona profesionalë nga institucion i pavarur dhe tërësisht i akredituar profesionalisht.

(9) Testi psikologjik do të zbatohet në bazë të testeve psikologjike të njohura ndërkombëtarisht për kryerjen e funksionit gjykatës ose prokuror publik.

### **Kompensimi për punë**

#### **Neni 68**

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit nga neni 67 i këtij ligji ka të drejtë të kompensimit lartësinë e të cilit me akt të veçantë e përcakton Këshilli Drejtues i Akademisë, kurse duke pasur parasysh numrin e kandidatëve të paraqitur, kohëzgjatjen e provimit pranues, ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të përgatitjes së provimit pranues, si dhe prezencën në mbledhje të Komisioneve.

### **Dhënia e provimit pranues**

#### **Neni 69**

(1) Provimi pranues jepet para Komisionit nga neni 67 i këtij ligji në përbërje të plotë.

(2) Për rrjedhën dhe procedurën e dhënies së provimit pranues kryetari i Komisionit nga neni 67 i këtij ligji para Këshillit Drejtues parashtron raport.

(3) Këshilli Drejtues e miraton raportin për zbatimin e provimit pranues, në mënyrë dhe në procedurë të rregulluar me Statutin e Akademisë.

### **Testi kualifikues**

#### **Neni 70**

(1) Testi kualifikues përmban njëqind pyetje nga të cilat:

- 20 nga sfera e të drejtës penale;
- 20 nga sfera e të drejtës civile;
- 15 nga sfera e të drejtës ndërkombëtare;
- 15 nga sfera e të Drejtës së BE;
- 10 nga sfera e të drejtës tregtare;
- 10 nga sfera e të drejtës kushtetuese;
- 10 nga sfera e të drejtës administrative;

(2) Pyetjet dhe përgjigjet e ofruara i përgatisin ligjëruesit në Akademi, të përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Akademisë, me ç'rast për çdo sferë janë përgatitur së paku 20 herë më shumë pyetje nga numri i paraparë i pyetjeve për testin kualifikues.

(3) Mësimdhënësit nga paragrafi 2 i këtij neni janë të obliguar të përgatitin nga 5 përgjigje për çdo pyetje, ashtu që njëra është e saktë, dy përgjigjet të pasakta, ndërsa janë të ngjashme me përgjigjen e saktë, një përgjigje nuk është e saktë në masë të vogël (në të humben pikë të vogël), dhe një përgjigje nuk është e saktë në masë të madhe, (në të humben pikë më shumë).

(4) Pyetjet e përgatitura me përgjigjet e ofruara kanë karakter të informacioneve të klasifikuara me shkallë " interne" dhe me to veprohet në pajtim me Ligjin për informacione të klasifikuara."

(5) Pyetjet e përgatitura dorëzohen në Akademi në formë elektronike.

### **Mënyra e zbatimit të testit kualifikues**

#### **Neni 71**

(1) Provimi jepet në lokale për dhënien e provimit, të pajisur në veçanti për dhënien e provimit profesional me pajisje materiale-teknike dhe informatike, lidhje të internetit dhe pajisje për incizim të provimit.

(2) Dënia e provimit incizohet dhe drejtpërdrejtë emitohet në ueb faqen e akademisë, e nëse për shkaqe teknike incizimi ndërpritet, ai publikohet në ueb faqen e Akademisë.

(3) Në lokalin për dhënien e provimit, gjatë provimit, krahas Komisionit për provim pranues në përbërje të plotë, sekretarit të Komisioni dhe ndihmës sekretarit të Komisionit, i pranishëm është informatikan që kujdeset për funksionimin më të mirë të pajisjes teknike dhe kompjuterike.

(4) Para fillimit të dhënies së provimit, kandidatët identifikohen në bazë të letërnjoftimit valid ose dokumentit të udhëtimit, me ç'rast kandidati merr një kod për qasje, respektivisht fjalëkalim me të cilin i miratohet qasja në sistemin elektronik, për dhënien e testit kualifikues.

(5) Kryetari e sqaron mënyrën e zgjidhjes së testit, si dhe e shpall fillimin e tij.

(6) Dhënia e testit kualifikues zgjatë 200 minuta.

(7) Pas miratimit të qasjes, kandidati merr një test elektronik për provimin, përmbajtja e të cilit, për momentin e kyçjes së kandidatit, sipas zgjedhjes së rastësishme e përcakton softueri i sistemit elektronik.

(8) Sistemi elektronik për dhënien e provimit, nuk mund të lejojë ekzistimin e përmbajtjes identike të testit elektronik për më shumë se një kandidat.

(9) Rezultatet nga dhënia e provimit janë të qasshme për kandidatin në kompjuterin ku e ka dhënë provimin, menjëherë pas përfundimit të tij.

(10) Rezultatet nga provimi kualifikues publikohen në ueb faqen dhe tabelën e publikimit të Akademisë.

### **Sistemi elektronik për dhënien e provimit kualifikues**

#### **Neni 72**

(1) Pyetjet e shënuara në testet për dhënien e provimit dhe përgjigjet e tyre ruhen në sistemin e vetëm elektronik për dhënien e provimit të testit kualifikues.

(2) Sistemi elektronik përmban bazë të qasshme prej së paku 2000 pyetjeve nga sfera e lëndëve të përcaktuara, për nevojat e përgatitjes së provimit. Së paku 50 përqind nga çështjet e literaturës profesionale që është në përdorim te 100 institucionet e arsimit të lartë, të radhitura më lartë në shkencat juridike në botë, sipas listës së fundit të Qendrës për universitete të klasës botërore pranë Universitetit Xhiao Tong në Shangai.

(3) Pyetjet publikohen, ripërtërihen një herë në vit, kurse sipas nevojës edhe disa herë me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të bazës së pyetjeve. Pyetjet mund të jenë të përkthyer joformalisht në gjuhë tjera.

### **Procesverbali**

#### **Neni 73**

Për rrjedhën e testit kualifikues, sekretari i Komisionit të Provimit Përfundimtar mban procesverbal ku shënohen të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë tërë procedurës së dhënies së provimit, që e nënshkruajnë kryetari, të gjithë anëtarët e Komisionit dhe sekretari i komisionit.



## **Sjellja e palejueshme e kandidatit dhe pamundësia teknike e funksionimit të sistemit elektronik**

### **Neni 74**

(1) Gjatë dhënies së provimit të testit të kualifikimit, kandidatët nuk guxojnë të përdorin çfarëdo qoftë mjete elektronike, mjete për komunikim ose ndihmesa tjera, përfshirë edhe ligjet, ligjet me komente dhe sqarime, lëndë të përgatitura paraprakisht, dokumente juridike, material të shkruar ose burime tjera të informatave.

(2) Gjatë testit të kualifikimit nuk është lejuar lëshimi i palejueshëm i lokalit në të cilin realizohet provimi nga ana e kandidatëve, përveç në rast urgjence, me ç'rast do të shoqërohen nga personat e autorizuar që mbikëqyrin testimin.

(3) Kandidati nuk i lejohet që gjatë testimit të kontaktojë kandidatët ose persona të tjerë, përveç me informatikanin, në rast se ka probleme teknike me kompjuterin.

(4) Nëse problemet teknike me kompjuterin mënjanohen për pesë minuta, provimi vazhdon, ndërsa nëse nuk mënjanohen në këtë afat, provimi ndërpritet vetëm për atë kandidat dhe do të realizohet në afat prej së paku tre ditëve nga dita e ndërprerjes së provimit.

(5) Nëse ka probleme teknike me më shumë se pesë kompjuterë nuk mënjanohen për pesë minuta, provimi ndërpritet për të gjithë kandidatët që janë në testim dhe do të do të realizohet në afat prej së paku tri ditëve nga dita e ndërprerjes së provimit.

(6) Nëse kandidati gjatë testimit vepron në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, do të largohet nga testimi, testi i tij do të asgjësohet dhe ai nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit dhe vlerësimit, me cka konsiderohet se nuk e ka kaluar testin kualifikues dhe e kjo konstatohet në procesverbalin për testin e kualifikimit.

(7) Personat e autorizuar nga paragrafi (2) i këtij neni, gjatë testimit nuk guxojnë që të qëndrojnë më gjatë se pesë sekonda në afërsi të kandidatit kur e jep provimin, përveç në rast të mënjanimit të problemit teknik, kur informatikani nga neni 71 paragrafi 3 nuk guxon që të qëndrojë afër më gjatë se pesë minuta.

### **Vlerësimi**

### **Neni 75**

(1) Testi kualifikues vlerësohet me notë prej "1" deri më "10" kurse nota merret në atë mënyrë që numri i pikëve të fituara pjesëtohet me 10.

(2) Në test mund të fitohen më së shumti 100 pikë.

(3) 5) Përgjigja e saktë e çdo pyetjeje vlerësohet me 1 pikë, përgjigjet që janë të ngjashme me përgjigjen e saktë vlerësohen me 0 pikë, kurse ato të ndryshmet dhe në vëllim të vogël vlerësohen me 0,5 pikë, përderisa ato që nuk janë të sakta vlerësohen me -1pikë, me ç'rast çdo pyetje e caktuar nga testi mund të përgjigjen me seleksionimin e vetëm një prej pesë përgjigjeve të ofruara.

(4) Mos përgjigja e çdo pyetjeje vlerësohet me -1 pikë.

(5) Konsiderohet se personi i paraqitur që ka marrë notën "4" ose vlerësim më të ulët në testin kualifikimit, nuk e ka kaluar testin kualifikues dhe nuk ka të drejtë që ta japë provimin psikologjik, testin e integritetit dhe provimin.

(6) Testi psikologjik vlerësohet me notën "mjaftueshëm" dhe "pamjaftueshëm".

(7) Konsiderohet se personi i paraqitur që ka marrë notën "pamjaftueshëm" në testin psikologjik, nuk e ka kaluar testin psikologjik dhe nuk ka të drejtë që ta japë testin e integritetit dhe provimin.

(8) Testi i integritetit vlerësohet me notën "mjaftueshëm", "pjesërisht mjaftueshëm" dhe "pamjaftueshëm".

(9) Konsiderohet se personi i paraqitur që ka marrë notën "pamjaftueshëm" në testin e integritetit, nuk ka të drejtë që të hyjë në provim.

(10) Komisioni i provimeve pranuese e verifikon vlerësimin për testin e integritetit me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i Komisioni.

### **Provimi**

#### **Neni 76**

(1) Provimi jepet në afat prej 7 ditëve nga publikimi i rezultateve përfundimtare të testit të integritetit.

(2) Të drejtë për testim në provimin pranues kanë kandidatët që i kanë kaluar testin kualifikues, psikologjik dhe testin e integritetit.

### **Qëllimi dhe përmbajtja e provimit**

#### **Neni 77**

(1) Provimi përbëhet prej pjesës praktike (me shkrim) dhe asaj me gojë.

(2) Pjesa praktike jepet me shkrim në formë elektronike duke u përgjigjur në një numër të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter dhe përbëhet nga detyrat e provimit për zgjidhjen e 2 studimeve të rastit (një lëndë penale, dhe një lëndë civile)

(3) Gjatë pjesës me gojë, kandidatët marrin nga një pyetje prej çdo studimi të rastit, një pyetje juridike (përfshirë edhe etikën gjyqësore - të prokurorisë) dhe një pyetje të kulturës së përgjithshme.

#### **Neni 78**

(1) Nëpërmjet zgjidhjes së studimit të rastit, kontrollohet njohuria teorike, aftësia për zbatimin e ligjeve në praktikë, mendimi logjik dhe analitik, shprehja juridike dhe komunikimi me shkrim i kandidatit.

(2) Nëpërmjet pjesës me shkrim kontrollohen njohuritë e kandidatit, aftësia e të shprehurit, elokuenca, kuptimi i rëndësisë së funksionit të gjykatësit ose prokurorit publik.

#### **Neni 79**

(1) Zgjedhja e lëndëve për përpilimin e studimit të rastit, kryhet në formë elektronike në mënyrë që kandidati paraqiten me kod për qasje në sistemin elektronik dhe softueri i sistemit elektronik me përzgjedhje të rastësishme përcaktohet nga baza e studimeve të rasteve nga një lëndë penale dhe nga një lëndë civile.

(2) Sistemi elektronik nga paragrafi 1 i këtij neni përmban bazë me qasje publike prej së paku 500 studimeve të rasteve, që janë përafërsisht të rëndësisë së njëjtë prej të cilave 250 penale dhe 250 civile. Studimet e rastit mund të jenë të përkthyer joformalisht në gjuhë tjera.

#### **Neni 80**

(1) Ligjëruesit, përpilojnë bazë të pyetjeve për secilën prej lëndëve nga neni 77, si dhe bazë të pyetjeve me gojë e cila përbëhet prej së paku 200 pyetjeve.

(2) Pyetjet me shkrim vlerësohen me 0,5 pikë dhe numri maksimal i pikëve prej katër pyetjeve është 2 pikë.

## **Mënyra e zbatimit të pjesës praktike (me shkrim) të provimit**

### **Neni 81**

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me mënyrën e dhënies së provimit kualifikues në formë elektronike zbatohen edhe në mënyrën e dhënies së pjesës praktike (me shkrim) të provimit përfundimtar, me ç'rast është e lejuar që të përdoren ligjet (pa komente dhe sqarime) që në versionin elektronik gjenden në kompjuterin ku kandidati i përgjigjet provimit praktik (pjesës me shkrim).

### **Neni 82**

(1) Pasi që kryetari i Komisionit do të publikojë fillimin e provimit, nuk lejohet hyrja e kandidatëve në lokalin ku realizohet provimi.

(2) Para fillimit të dhënies së provimit, kryetari i Komisionit i njofton kandidatët me mënyrën e zbatimit të provimit, me ç'rast kryetari e shpall fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e testit.

(3) Për zgjidhjen e rastit, kandidatët kanë në dispozicion 120 minuta për secilën lëndë.

## **Procesverbali**

### **Neni 83**

Për rrjedhën e provimit me shkrim, sekretari i Komisionit mban procesverbal ku shënohen të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë tërë procedurës së dhënies së provimit, që e nënshkruajnë kryetari, të gjithë anëtarët e Komisionit dhe sekretari i komisionit.

## **Mënyra e zbatimit të pjesës së provimit me gojë**

### **Neni 84**

(1) Pjesa me gojë e provimit mbahet në afatet e përcaktuara nga Komisioni, kurse në dinamik që varet nga numri i kandidatëve.

(2) Zgjedhja e pyetjeve me gojë kryhet para Komisionit, për secilin kandidat në veçanti.

### **Neni 85**

(1) Zgjedhja e pyetjeve me gojë për çdo kandidat kryhet në formë elektronike në mënyrë që kandidati kyçet me kod për qasje në sistemin elektronik me ç'rast softueri i sistemit elektronik me ygjedhje të rastësishme përcakton katër pyetje për kandidatin, prej të cilave nga një pyetje për secilën prej dy studimeve të rastit, një pyetje juridike (përfshire edhe etikën gjyqësore dhe të prokurorisë) dhe një pyetje nga kultura e përgjithshme.

(2) Sekretari i Komisionit përpilon procesverbal për rrjedhën e zhvillimit të pjesës së provimit me gojë për secilin kandidat. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari i Komisionit, anëtarët e Komisionit dhe sekretari.

## **Vlerësimi i provimit**

### **Neni 86**

(1) Provimi vlerësohet me notën prej "1" deri "10" me ç'rast 1 pikë është e barabartë me notën 1, kurse 10 pikë është e barabartë me notën 10.

(2) Pjesa me shkrim e provimit vlerësohet me notën prej 0 deri 8 pikë.

(3) Konsiderohet se kandidati që ka marrë notën "4" ose notë më të ulët nuk e ka dhënë testin kualifikues.

(4) Çdo studim i rastit zgjidhet me studimin e të njëjtit dhe përgjigjen e 8 pyetjeve, që dalin nga studimi, me dhjetë opsione të mundshme të ofruara për përgjigjet prej të cilave njëra është e

saktë, pesë janë të ngjashme me të saktën, e të pasakta dhe katër të ndryshme me të saktën, por të pasakta.

(5) Përgjigja e saktë e çdo pyetjeje vlerësohet me 0,5 pikë, përgjigjet që janë të ngjashme me përgjigjen e saktë vlerësohen me 0 pikë, kurse ato të ndryshmet vlerësohen me -1 pikë, me ç'rast çdo pyetje e veçantë e testit mund të përgjigjet me seleksionimin e vetëm një prej dhjetë përgjigjeve të ofruara.

(6) Pyetja e papërgjigjur vlerësohet me -1 pikë.

### **Konstatimi dhe publikimi i rezultateve të provimit**

#### Neni 87

(1) Në bazë të rezultateve të mara nga të dy pjesët e provimit, Komisioni për provim pranues përpilon listë preliminare të radhitjes dhe e publikon më së voni në afat prej 48 orëve pas përfundimit të mbajtjes së provimit.

(2) Për vlerësimin e provimit dhe rezultatet e konstatuara, Komisioni përpilon procesverbal të veçantë që e nënshkruan kryetari i Komisionit dhe sekretari.

(3) Rang-lista preliminare publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Akademisë.

### **E drejta e kundërshtimit**

#### Neni 88

(1) Kandidati i pakënaqur nga nota e marrë, ka të drejtë ankese te Komisioni i provimit pranues në afat prej 3 ditësh nga dita e publikimit të rezultateve në ueb faqen zyrtare dhe në tabelën e shpalljeve të Akademisë.

(2) Komisioni është i obliguar që të vendosë ndaj kundërshtimit në afat prej 2 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të kundërshtimit në Akademi.

(3) Kundër vendimit të Komisionit të provimit pranues, kandidati që nuk është i kënaqur ka të drejtë ankese te Këshilli drejtuesi i Akademisë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(4) Këshilli drejtues vendimin ndaj ankesës e miraton në afat prej 3 ditësh duke llogaritur nga skadimi i afatit për parashtrimin e ankesave kundër vendimeve të Komisionit të provimit pranues.

(5) Në seancën e Këshillit drejtues ku shqyrtohen ankesat merr pjesë edhe kryetari i Komisionit ose anëtari që do të përcaktohet nga ai, pa të drejtë vote.

(6) Këshilli drejtues me konkluzion e pranon ose refuzon ankesën e kandidatit, kurse ankesat e vonuara i hedh poshtë, kurse kzemplari i konkluzionit i dorëzohet kandidatit.

(7) Nëse Këshilli drejtues e pranon ankesën e kandidatit, do ta obligojë Komisionin që të kryjë rikontroll dhe rivlerësim të testit kualifikues të kandidatit.

(8) Kundër vendimit të Këshillit drejtues nga paragrafi (7) i këtij neni, kandidati i pakënaqur në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit mund të ngritë kontest administrativ para Gjykatës Administrative.

(9) Për ankesën nga paragrafi 8 i këtij neni, Gjykata Administrative vendos në afat prej 5 ditësh.

(10) Kundër vendimit të Gjykatës Administrative nga paragrafi 9 i këtij neni, lejohet ankesë te Gjykata e lartë administrative në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Gjykatës Administrative.

(11) Gjykata e lartë administrative për ankesën nga paragrafi 10 i këtij neni, vendos në afat prej 7 ditësh nga pranimi i ankesës.

#### Neni 89

Pas plotfuqishmërisë së vendimit nga neni 88, Komisioni i provimit pranues e publikon rang-listën me rezultatet përfundimtare të kandidatëve që e kanë dhënë provimin.

### **Publikimi i notës përfundimtare të provimit pranues**

#### Neni 90

(1) Nota përfundimtare e provimit pranues paraqet përmbledhje të vlerësimit të testit kualifikues dhe të provimit.

(2) Komisioni i provimit pranues në bazë të vlerësimit përfundimtar, në pajtim me nenin 87 paragrafi 1 të Ligjit, përcakton rang-listë të dëgjuesve të trajnimit fillestar dhe atë e publikon në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e Akademisë.

#### Neni 91

(1) Pranimi i kandidatëve që do ta ndjekin trajnimin fillestar në Akademi bëhet në bazë të radhitjes së suksesit në rang-listë deri në plotësimin e numrit të paraparë të ndjekësve të përcaktuar me vendimet nga neni 56 paragrafi 2 të ligjit.

(2) Nëse kandidati i pranuar heq dorë nga trajnimi fillestar, është i obliguar që për këtë ta njoftojë Akademinë më së voni 15 ditë para fillimit të mësimit teorik.

(3) Në rastin nga paragrafi 2 i këtij neni, Akademia e plotëson atë vend të lirë me kandidatin e parë të radhës nga rang-lista përfundimtare e ndjekësve të trajnimit fillestar.

### **Mënyra e veprimit me dokumentet e provimit dhe ruajtja e tyre**

#### Neni 92

(1) Testi kualifikues, materialet e provimit, formulari për plotësimin e përgjigjeve dhe të gjitha shkresat tjera dhe materialet të provimit, të dorëzuara nga kandidati dhe të përpiluara nga Komisioni i provimit pranues, do të bashkëngjiten në dosjen personale të kandidatëve të suksesshëm në Akademi dhe me to veprohet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjin për qasje të lirë deri te informatat me karakter publik, e ruhen sipas rregullave për punë arkivore.

(2) Këshilli drejtues i Akademisë kryen revizion të mënyrës së zbatimit të provimit pranues, dhe nëse konstatohen veprime në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, e shfuqizon atë pjesë të provimit ku janë konstatuar parregullsitë.

(3) Kandidatëve që nuk e kalojnë testin u kthehen dokumentet e dorëzuara me fletëparaqitjen, e testet e tyre dhe materialet tjera të provimit si dhe incizimet e testit elektronik ruhen në arkiv sipas rregullave për punë arkivore.

### **Statusi i ndjekësve të trajnimit fillestar**

#### Neni 93

(1) Me marrjen e statusit të ndjekësit të trajnimit fillestar në Akademi, dëgjuesi krijon marrëdhënie pune në kohë të caktuar në Akademi për periudhën e zbatimit të trajnimit fillestar deri në zgjedhjen e kandidatit për gjykatës ose prokuror publik, për gjykatës në gjykatë themelore, respektivisht për prokuror publik në prokurorinë publike themelore.

(2) Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës nga paragrafi (1) i këtij neni, dëgjuesi i trajnimit fillestar, respektivisht kandidati për gjykatës ose prokuror publik ka të drejtë page të këshilltarit të lartë gjyqësor në gjykatë themelore dhe kompensime tjera të pagës në pajtim me ligjin.

(3) Mënyra e zbatimit të trajnimit fillestar, si dhe të drejtat dhe obligimet e dëgjuesve të trajnimit fillestar rregullohen me Statutin dhe aktet e përgjithshme të Akademisë.

(4) Nëse dëgjuesi gjatë trajnimit fillestar heq dorë ose e ndërpret trajnimin, obligohet që t'i kompensojë shpenzimet dhe kompensimet tjera për trajnimin e tij sipas përlllogaritjes së përcaktuar nga ana e Akademisë.

(5) Dëgjuesi i trajnimit fillestar nuk do t'i kompensojë shpenzimet nga paragrafi (4) i këtij neni nëse ka hequr dorë ose e ka ndërprerë trajnimin për shkaqe shëndetësore që pamundësojnë ndjekjen e trajnimit më gjatë se një muaj që dëshmohet me vërtetim mjekësor.

### **Përmbajtja dhe kohëzgjatja e trajnimit fillestar**

#### **Neni 94**

(1) Trajnimi fillestar i përfshin zbatimin e ligjeve materiale dhe proceduese, praktiken dhe etikën gjyqësore dhe të prokurorisë publike, standardet ndërkombëtare juridike, punimet shkencore dhe profesionale në sferën e së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe shkathtësitë e funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik.

(2) Trajnimi fillestar për ndjekësit zgjat 24 muaj dhe zhvillohet në dy faza, si vijon:

- faza e parë - mësimi teorik në Akademi në kohëzgjatje prej nëntë muajsh dhe

- faza e dytë - mësimi praktik në gjykata dhe prokurori publike dhe institucione tjera, në pajtim me programin për trajnim fillestar në kohëzgjatje prej 15 muajsh. Në kuadër të fazës së dytë të trajnimit, kandidatët detyrimisht kalojnë stazhim njëmuajor në gjykatë ndërkombëtare.

(3) Gjykata, respektivisht prokuroria publike në të cilën dëgjuesi do ta ndjekë fazën e dytë të trajnimit fillestar, caktohet në mënyrë rajonale sipas rajonit të apelit në të cilën ndjekësi e ka vendbanim, respektivisht vendqëndrim.

### **Qëllimet e përgjithshme të mësimit teorik dhe praktik në Akademi**

#### **Neni 95**

(1) Qëllimi i mësimit teorik në Akademi është që te ndjekësit të zhvillojë njohuri më të gjera të përgjithshme nga e drejta materiale dhe procesuese vendore dhe ndërkombëtare dhe e drejta e Bashkimit Evropian në aspekt praktik, zhvillimi i specifikave teknike për profesionin e gjykatësit - prokurorit, aftësinë për të menduarit të logjikshëm, njoftimin me aspektet sociale, kulturore dhe ekonomike të së drejtës, si dhe transparencës ndaj ambientit social me praktikimin e moduleve adekuate në gjykatë dhe prokurori publike dhe institucione tjera.

(2) Qëllimi i mësimit praktik është thellimi i njohurive dhe shkathtësive që ndjekësit i kanë marrë në fazën e parë, zhvillimin e shkathtësive praktike të gjykatësve - prokurorëve në pajtim me standardet për kualitet dhe efikasitet, forcimi i ndjenjës së përgjegjësisë, aftësive për udhëheqjen e një procesi, miratimin e vendimeve dhe arsyetimin e tyre, si dhe aftësinë për kryerjen etike të funksionit të gjykatësit ose prokurorit publik.

(3) Qëllimet e mësimit teorik dhe praktik në Akademi realizohen në pajtim me programin për zbatimin e trajnimit fillestar. ]

### **Vlerësimi gjatë trajnimit fillestar**

#### **Neni 96**

(1) Suksesi i arritur në fazën e parë - mësimin teorik në Akademi vlerësohet më së shumti deri në 30 pikë dhe për këtë përpilohet rang-lista e ndjekësve dhe ajo publikohet në ueb faqen e Akademisë.

(2) Ndjekësit e trajnimit fillestar që janë të radhitur më lartë në rang-listën nga paragrafi (1) të këtij neni, kanë të drejtë që të përcaktohen për kryerjen e profesionit të gjykatësit ose

prokurorit publik deri në plotësimin e vendeve për gjykatës ose prokuror publik në pajtim me vendimet e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë nga neni 56 paragrafi (2) i këtij ligji, e ndjekësit tjerë nga rang-lista nga paragrafi (1) të këtij neni sistemohen në vendet e mbetura për gjykatës, respektivisht prokuror publik.

(3) Kusht që ndjekësi të kalojë në fazën e dytë - mësimin praktik të trajnimit është që të marrë së paku 21 pikë nga sukseksi i arritur në fazën e parë të trajnimit. Kandidati që në fazën e parë të trajnimit do të marrë më pak se 21 pikë, i pushon statusi i ndjekësit të trajnimit fillestar.

(4) Sukseksi i arritur në fazën e dytë - mësimin praktik në Akademi vlerësohet më së shumti deri në 20 pikë dhe për këtë përpilohet rang-lista e ndjekësve që publikohet në ueb faqen e Akademisë.

(5) Kushti që dëgjuesi të japë provimin përfundimtar është që të marrë së paku 14 pikë nga sukseksi i arritur në fazën e dytë të trajnimit. Kandidatit që në fazën e dytë të trajnimit do të marrë më pak se 14 pikë, i pushon statusi i ndjekësit të trajnimit fillestar.

(6) Humbja e statusit të dëgjuesit të trajnimit fillestar nga paragrafët (3) dhe (5) të këtij neni kanë si pasojë kompensimin e shpenzimeve dhe kompensimeve tjera për trajnimin e tij sipas një përllogaritjes së përcaktuar nga ana e Akademisë.

### **Provimi përfundimtar**

#### **Neni 97**

Pas përfundimit të trajnimit fillestar, ndjekësit e trajnimit fillestar hyjnë në provimin përfundimtar ku kontrollohen njohuria praktike dhe aftësitë e fituara në trajnimin fillestar për kryerjen e funksionit të gjykatësit në gjykatat themelore, prokuror publik në prokuroritë publike themelore.

### **Komisioni i provimit përfundimtar**

#### **Neni 98**

(1) Provimi përfundimtar jepet para Komisionit për provim përfundimtar i përbërë nga kryetari, tetë anëtarë dhe zëvendësit e tyre me mandat prej dy sesioneve të provimeve dhe sekretari nga radhët e nëpunësve administrativë në Akademi.

(2) Këshilli drejtues e zgjedh dhe konstituon Komisionin nga paragrafi (1) i këtij neni në përbërje: katër anëtar dhe zëvendës të tyre me propozim të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radhët e gjykatësve, dy anëtarë dhe zëvendës të tyre me propozim të Këshillit të Prokurorëve

Publikë të Republikës së Maqedonisë nga radhët e prokurorëve publikë, një anëtar dhe zëvendës i tij nga Shoqata e Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, një anëtar dhe zëvendës i tij nga Shoqata e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë dhe një anëtar dhe zëvendës i tij me propozim të ministrit të Drejtësisë nga radhët e nëpunësve udhëheqës shtetërorë në ministrinë e Drejtësisë.

(3) Kryetarin e Komisionit për Provimin Përfundimtar, Këshilli Drejtues e zgjedh nga radhët e gjykatësve dhe prokurorëve publikë.

(4) Anëtarët dhe zëvendësit e Këshillit Drejtues, Këshillit Programor, Komisionit për Provimin Pranues, drejtorin, si dhe ligjëruesit dhe mentorët që në atë periudhë janë angazhuar në trajnimin fillestar, nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Anëtari i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ose Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, ministri i Drejtësisë, respektivisht zëvendësministri i Drejtësisë, nuk mund të jenë anëtarë të Komisionit për Provimin Përfundimtar.

(6) Kryetar, anëtar dhe zëvendës të tyre të Komisionit për provimin përfundimtar mund të jenë gjykatësit dhe prokurorët publikë të zgjedhur, si dhe nëpunësit udhëheqës shtetërorë në

Ministrinë e Drejtësisë, që në karrierën e deriatëhershme profesionale shquhen me profesionalizëm, etikë, rezultate të dëshmuara në punë dhe që gëzojnë autoritet të lartë në jurisprudencë.

(7) Kryetari dhe anëtarët e Komisionit për provimin përfundimtar kanë të drejtë kompensimi lartësia e të cilit me aktin e veçantë e përcakton Këshilli Drejtues i Akademisë, duke marrë parasysh numrin e kandidatëve që e japin provimin përfundimtar, kohëzgjatjen e provimit, ndërlikueshmërinë e aktiviteteve të përgatitjes dhe zbatimit të provimit përfundimtar, si dhe praninë në seancat e Komisionit.

### **Procedura e dhënies së provimit para Komisionit për provimin përfundimtar**

#### Neni 99

(1) Provimi përfundimtar jepet në përbërje të plotë para Komisionit për provimin përfundimtar.

(2) Për rrjedhën dhe procedurën e dhënies së provimit përfundimtar, kryetari i Komisionit nga neni 98 i këtij ligji, parashtron raport te Këshilli Drejtues për miratim.

### **Qëllimi dhe përmbajtja e provimit**

#### Neni 100

(1) Provimi përbëhet prej pjesës praktike (me shkrim) dhe asaj me gojë.

(2) Pjesa praktike jepet me shkrim në formë elektronike duke u përgjigjur në numër të caktuar të pyetjeve në formë të zgjidhjes së testit elektronik në kompjuter dhe përbëhet nga detyra e provimit për zgjidhjen e 2 studimeve të rastit (një lëndë penale, dhe një lëndë civile gjyqësore).

(3) Gjatë pjesës me gojë, kandidatët marrin nga një pyetje prej çdo studimi të rastit, një pyetje juridike (duke e përfshirë edhe etikën gjyqësore - të prokurorisë) dhe një pyetje të kulturës së përgjithshme.

#### Neni 101

(1) Përmes zgjidhjes së studimit të rastit, kontrollohet njohuria teorike, aftësia për zbatimin e ligjeve në praktikë, mendimi logjik dhe analitik, shprehja juridike dhe komunikimi me shkrim i kandidatit.

(2) Përmes pjesës me gojë kontrollohen njohuritë e kandidatit, aftësia e të shprehurit, elokuenca, njohja e rëndësisë së funksionit të gjykatësit ose prokurorit publik.

#### Neni 102

(1) Zgjedhja e lëndëve për përpilimin e studimit të rastit, kryhet në formë elektronike në mënyrë që kandidati paraqitet me kod për qasje në sistemin elektronik dhe softuerin e sistemit elektronik me përzgjedhje të rastësishme përcaktohet nga baza e studimeve të rasteve nga një lëndë penale dhe një lëndë civile.

(2) Sistemi elektronik nga paragrafi 1 i këtij neni përmban bazë me qasje publike prej së paku 500 studimeve të rasteve, që janë përafërsisht të rëndësisë së njëjtë prej të cilave 250 penale dhe 250 civile. Studimet e rastit mund të jenë të përkthyer joformalisht në gjuhë tjera.

#### Neni 103

(1) Ligjëruesit, përpilojnë bazë të pyetjeve për secilën prej lëndëve nga neni 100, si dhe bazë të pyetjeve me gojë e cila përbëhet prej së paku 200 pyetjeve.

(2) Pyetjet me gojë vlerësohen me 0,5 pikë dhe numri maksimal i pikëve prej katër pyetjeve është 2 pikë.



## **Mënyra e zbatimit të pjesës praktike (me shkrim) të provimit**

### **Neni 104**

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me mënyrën e dhënies së provimit kualifikues në formë elektronike zbatohen edhe në mënyrën e dhënies së pjesës praktike (me shkrim) të provimit përfundimtar, me ç'rast lejohet shfrytëzimi i ligjeve (pa komente dhe sqarime) që në versionin elektronik gjenden në kompjuterin ku kandidati e jep provimin praktik (pjesën me shkrim).

### **Neni 105**

(1) Pasi që kryetari i Komisionit të provimit përfundimtar do ta shpallë fillimin e provimit, nuk lejohet hyrja e kandidatëve në hapësirën ku realizohet provimi.

(2) Para fillimit të dhënies së provimit, kryetari i Komisionit për provimin përfundimtar i njofton kandidatët me mënyrën e zbatimit të provimit, me ç'rast kryetari e shpall fillimin, kohëzgjatjen dhe përfundimin e testit.

(3) Për zgjidhjen e rastit, kandidatët kanë në disponim 120 minuta për secilën lëndë.

## **Procesverbali**

### **Neni 106**

Për rrjedhën e provimit me shkrim, sekretari i Komisionit të provimit përfundimtar mban procesverbal ku shënohen të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë tërë procedurës së dhënies së provimit, që e nënshkruajnë kryetari, të gjithë anëtarët e Komisionit për provimin përfundimtar dhe sekretari i Komisionit.

## **Mënyra e zbatimit të pjesës së provimit me gojë**

### **Neni 107**

(1) Kandidatët thirren nga sekretari i Komisionit për provimin përfundimtar.

(2) Zgjedhja e pyetjeve me gojë kryhet para Komisionit për provimin përfundimtar, për secilin kandidat në veçanti.

### **Neni 108**

(1) Zgjedhja e pyetjeve me gojë për çdo kandidat kryhet në formë elektronike në mënyrë që kandidati kyçet me kod për qasje në sistemin elektronik me ç'rast softueri i sistemit elektronik me zgjedhje të rastësishme përcakton katër pyetje për kandidatin, prej të cilave një pyetje për secilën prej dy studimeve të rastit, një pyetje juridike (duke përfshirë edhe etikën gjyqësore dhe të prokurorisë) dhe një pyetje nga kultura e përgjithshme.

(2) Sekretari i Komisionit për provimin përfundimtar përpilon procesverbal për rrjedhën e pjesës me gojë të provimit për secilin kandidat. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari i Komisionit për provimin përfundimtar, anëtarët e Komisionit dhe sekretari.

## **Vlerësimi i provimit**

### **Neni 109**

(1) Provimi vlerësohet me notën prej "1" deri "10" me ç'rast 1 pikë është e barabartë me notën 1, kurse 10 pikë janë të barabarta me notën 10.

(2) Pjesa me shkrim e provimit vlerësohet me notën prej 0 deri 8 pikë.

(3) Konsiderohet se kandidati që ka marrë notën "6" ose notë më të ulët nuk e ka dhënë provimin përfundimtar.

(4) Çdo studim i rastit zgjidhet me studimin e të njëjtit dhe përgjigjen e 8 pyetjeve, që dalin nga studimi, me dhjetë opsione të mundshme të ofruara për përgjigjet prej të cilave njëra është e saktë, pesë janë të ngjashme me të saktën, kurse të pasakta dhe katër të ndryshme me të saktën, e të pasakta.

(5) Përgjigja e saktë e çdo pyetjeje vlerësohet me 0,5 pikë, përgjigjet që janë të ngjashme me përgjigjen e saktë vlerësohen me 0 pikë, kurse ato të ndryshmet vlerësohen me -1 pikë, me ç'rast në çdo pyetje e veçantë nga testi mund të përgjigjet me seleksionimin e vetëm një prej dhjetë përgjigjeve të ofruara.

(6) Pyetja e papërgjigjur vlerësohet me -1 pikë.

(7) Ndjekësi i trajnimit fillestar që nuk e ka dhënë provimin përfundimtar, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e dhënies së provimit përfundimtar, ka të drejtë të dhënies së sërishme të provimit përfundimtar.

(8) Nëse dëgjuesi i trajnimit fillestar gjatë provimit të sërishëm të testit përfundimtar merr notën "6" ose notë më të vogël, konsiderohet se nuk e ka përfunduar trajnimin fillestar dhe e humb statusin e ndjekësit të trajnimit fillestar.

(9) Kandidati i pakënaqur ka të drejtë ankese te Komisioni për provimin përfundimtar në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit. Pas vendimit të Komisionit të provimit përfundimtar, kandidati ka të drejtë ankese te Këshilli Drejtuesi i Akademisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(10) Humbja e statusit të dëgjuesit të trajnimit fillestar nga paragrafi (5) i këtij neni ka si pasojë kompensimin e shpenzimeve dhe kompensimeve tjera për trajnimin e tij sipas përlllogaritjes së përcaktuar nga ana e Akademisë.

### **Vlerësimi përfundimtar**

#### **Neni 110**

Pas përfundimit të trajnimit fillestar, ndjekësi merr vlerësimin përfundimtar, që paraqet një përmbledhje të notave të marra nga të dy fazat e trajnimit fillestar dhe të provimit përfundimtar.

### **Rang-lista përfundimtare**

#### **Neni 111**

Komisioni për provimin përfundimtar e përcakton rang-listën përfundimtare të kandidatëve për gjykatës ose prokurorë publikë në bazë të vlerësimit përfundimtar nga neni 110 i këtij ligji.

### **Vërtetimi për trajnimin e kryer fillestar**

#### **Neni 112**

(1) Akademia kandidatëve për gjykatës ose prokurorë u lëshon vërtetim për trajnimin e kryer fillestar që përmban vlerësim për çdo fazë të trajnimit dhe vlerësim përfundimtar.

(2) Vërtetimi nga paragrafi (1) i këtij neni, jepet sipas formularit që përcaktohet me aktin e Këshillit Drejtues.

### **Të drejtat dhe obligimet e kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë**

#### **Neni 113**

(1) Pas përfundimit të trajnimit fillestar të ndjekësi i trajnimit fillestar, e merr statusin e kandidatit për gjykatës ose prokuror publik.

(2) Pas përfundimit të trajnimit fillestar dhe marrjes së statusit të kandidatit për gjykatës ose prokuror publik deri në përzgjedhjen për gjykatës ose prokuror publik,

(3) Akademia e dërgon kandidatin për gjykatës, respektivisht për prokuror publik në gjykatë, respektivisht në prokurori publike ku e ka realizuar fazën e dytë të trajnimit fillestar për praktikimin e funksionit të gjykatësit ose prokurorit

(4) nën mentorim të gjykatësit ose prokurorit publik, në pajtim me programin e miratuar nga Akademia.

(5) Përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve publikë në gjykatat themelore dhe në prokuroritë publike themelore nga radhët e kandidatëve që e kanë kryer trajnimin fillestar, në bazë të shpalljeve të publikuara për zgjedhje nga ana e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, kryhet me radhë sipas suksesit të arritur, të përcaktuar në rang-listën përfundimtare.

(6) Tre kandidatët e parë të rang-listës përfundimtare kanë të drejtë që të konkurrojnë për zgjedhje të gjykatësit ose prokurorit publik në rajonin e apelit ku e kanë realizuar fazën e dytë të trajnimit fillestar, ose në cilindo rajon tjetër të apelit.

(7) Kandidatët tjerë për gjykatës ose prokurorë publikë të rang-listës përfundimtare janë të obliguar që të konkurrojnë për çdo shpallje të publikuar për zgjedhje të gjykatësit në gjykatën themelore ose prokuror publik në prokurori publike themelore.

(6) Nëse për vendin e caktuar për zgjedhje të gjykatësit ose prokurorit publik paraqiten kandidatë me të njëjtin numër të pikëve, përparësi gjatë zgjedhjes ka kandidati për gjykatës ose prokuror publik nga rajoni i apelit ku e ka realizuar fazën e dytë të trajnimit fillestar.

(7) Nëse kandidati për gjykatës ose prokuror publik dy herë vijimisht nuk paraqitet në shpalljet e publikuara nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, e humb statusin e kandidatit për gjykatës ose prokuror publik.

(8) Humbja e statusit të kandidatit për gjykatës dhe prokuror publik nga paragrafi (7) i këtij neni kanë si pasojë kompensimin e shpenzimeve dhe kompensimeve tjera për trajnimin e tij sipas përlllogaritjes së përcaktuar nga ana e Akademisë.

(9) Kandidati për gjykatës ose prokuror publik është i obliguar që së paku pesë vite pas zgjedhjes për gjykatës ose prokuror publik të punojë në gjykatë, respektivisht në prokurori publike, në të kundërtën është i obliguar që t'i kompensojë shpenzimet dhe kompensimet tjera për trajnimin e tij, sipas përlllogaritjes së caktuar nga ana e Akademisë.

### **3. Trajnimi i vazhdueshëm**

#### **Nocioni dhe qëllimi**

##### Neni 114

(1) Trajnimi i vazhdueshëm paraqet përsosje të vazhdueshme profesionale të njohurive teorike dhe praktike dhe shkathtësive për kryerje profesionale dhe efikase të funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik, funksionit të gjykatësit dhe prokurorit publik të prokurorive publike themelore, shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurori publike si dhe subjekteve nga neni 1 i këtij ligji.

(2) Trajnimi i vazhdueshëm mund të jetë i detyrueshëm dhe vullnetar.

(3) Trajnimi i vazhdueshëm është i detyrueshëm për gjykatësit, prokurorët publikë, kryetarët e gjykatave dhe prokurorët publikë të prokurorive publike.

(4) Shfrytëzuesit e trajnimit të vazhdueshëm, që është vullnetar, janë shërbimet profesionale në gjyqësi dhe prokurori publike, si dhe subjektet nga neni 1 i këtij ligji.

(5) Akademia e organizon trajnimin e vazhdueshëm në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj.

#### Neni 115

(1) Trajnimi i vazhdueshëm për përsosje profesionale zbatohet me qëllim të përsosjes dhe zgjerimit të njohurive dhe profesionalizimit të gjykatësve dhe prokurorëve publikë gjatë kryerjes së funksionit të gjykatësit dhe të prokurorit publik, forcimit të pavarësisë së tyre dhe integritetit si parakusht themelor për sundimin e të drejtës, për mbrojtjen të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe krijimin e gjyqësisë transparente, jurisprudencës së drejtë dhe efikase, të bazuar në standarde ndërkombëtare për gjykim fer dhe të drejtë.

(2) Trajnimet e vazhdueshme për përsosje profesionale të dedikuara për kryetarët e gjykatave dhe të prokurorëve publik të prokurorive publike kanë për qëllim zhvillimin e aftësisë për menaxhim me punët në kompetencë të tyre, të përcaktuar me ligj.

(3) Trajnimi i vazhdueshëm për përsosje profesionale të shërbimeve profesionale në gjyqësi dhe prokurori publike, si dhe subjektet nga neni 1 i këtij ligji që marrin pjesë në zbatimin e ligjeve nga sfera e jurisprudencës, zbatohet me qëllim të marrjes dhe avancimit të njohurive të nevojshme për përkrahje kualitative profesionale dhe teknike dhe ndihmë për gjykatësit dhe prokurorët publikë në punën e tyre të përditshme, si dhe përsosjen e tyre profesionale për zbatim efikas të ligjeve nga sfera e jurisprudencës.

(4) Ligjëruesit që e zbatojnë trajnimin konkret të vazhdueshëm, bëjnë kontroll të efikasitetit të çdo trajnimi të zbatuar përmes kontrollimit të njohurive dhe shkathtësive nga trajnimi konkret.

(5) Mënyra e zbatimit të kontrollit, rregullohet me aktet e përgjithshme të Akademisë.

### **Programi i përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm**

#### Neni 116

(1) Trajnimi i vazhdueshëm për përsosjen profesionale të gjykatësve, prokurorëve publikë, kryetarëve të gjykatave dhe prokurorëve publikë të prokurorive publike zbatohet në pajtim me Programin për trajnimin e vazhdueshëm.

(2) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe mënyra e zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet në Programin e përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm.

### **Programi i specializuar për trajnimin e detyrueshëm të vazhdueshëm**

#### Neni 117

(1) Gjykatësit dhe prokurorët publikë të sapozgjedhur janë të obliguar që menjëherë pas zgjedhjes së gjykatësit ose prokurorit publik ta ndjekin trajnimin e vazhdueshëm.

(2) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe mënyra e zbatimit të trajnimit të vazhdueshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet në Programin e specializuar për trajnim të detyrueshëm të vazhdueshëm.

### **Programi i specializuar për trajnimin vullnetar të vazhdueshëm**

#### Neni 118

(1) Akademia është e obliguar që një herë në vit më së voni deri më 1 dhjetor të përpilojë program për trajnim të vazhdueshëm vullnetar për vitin e ardhshëm.

(2) Për programin nga paragrafi (1) të këtij neni, Akademia i njofton gjykatat, prokuroritë publike dhe subjektet nga neni 1 i këtij ligji.

(3) Përmbajtja, kohëzgjatja dhe zbatimi i trajnimit të vazhdueshëm vullnetar nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohet në Programin e specializuar për trajnim të vazhdueshëm vullnetar.

(4) Trajnimi vullnetar i vazhdueshëm nga paragrafi (1) i këtij neni, organizohet së paku një herë gjatë vitit.

## **Mbikëqyrja**

### **Neni 119**

Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij ligji kryhet nga Ministria e Drejtësisë.

## **VIII DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 120**

Drejtori, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshilli Programor i Akademisë, të emëruar në pajtim me Ligjin për Akademinë për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 88/2010, 166/12 dhe 26/13), do t'i kryejnë kompetencat e tyre deri në zgjedhjen e organeve të Akademisë në pajtim me këtë ligj.

### **Neni 121**

Aktet e parapara nënligjore në këtë ligj do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 122**

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji shfuqizohet Ligji për Akademinë për Trajnimin e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 88/2010, 166/12 dhe 26/13 ).

### **Neni 123**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", e do të fillojë të zbatohet tre muaj nga dita e hyrjes në fuqi.